



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Nr. 645/8 Prot.

Tiranë, më 15.09.2021

Miratohet

KRYETAR

Arben SHEHU

Raport Auditimi Performance
“Pastrimi i Qytetit”



RAPORT AUDITIMI

“Pastrimi i Qytetit”

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nr. 645/3 prot., datë 01.10.2020.

Faza e studimore e auditimit nisi në datë 03.07.2020 me shkresën “Njoftim për fillimin e auditimit” nr. 645/1, datë 02.07.2020 dhe përfundoi me hartimin e programit të cituar më lart.

Faza e terrenit të auditimit nisi më datë 01.10.2020 me programin e auditimit cituar më lart dhe përfundoi më 13.11.2020, moment në të cilin ka nisur hartimi i projekt raportit të auditimit.

Me shkresën nr. 11043/1, datë 11.01.2021 “Observacion për KLSH”, protokolluar në KLSH me nr.645/5, datë 15.01.2021, Bashkia Vlorë ka paraqitur komentet mbi gjetjet dhe konkluzionet e projekt-raportit të auditimit, të cilat janë trajtuar në këtë raport përfundimtar.

Dosja audituese kaloi në filtrin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Performancës, Drejtorisë së Kontrollit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, dhe më pas iu përcoll Kryetarit për Vendimin Përfundimtar.

PËRMBAJTJA

8	Lista e shkurtimeve.....	5
1.	Rëndësia e Auditimit	6
1.1	Konteksti i problemit social	6
1.2	Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës	6
1.3	Auditime të mëparshme në këtë fushë	7
1.4	Subjekti nën auditim	8
1.4.1	Hyrje në subjektet në auditim	8
1.4.2	Politikat e institucionit/agjencisë	8
1.4.3	Pesha në buxhet.....	8
1.4.4	Risqet e aktiviteteve të subjekteve	9
1.4.5	Rëndësia e produkteve të subjektit.....	10
1.4.6	Feedback-u i subjektit	10
2.	Qasja dhe detajet e auditimit	11
2.1	Objektivi dhe problemi.....	11
2.2	Fokusimi dhe përkufizimi i problemit	11
2.3	Përkufizimet dhe terminologjia.....	11
2.4	Kriteret	12
2.4.1	Kriteret e politikës.....	12
2.4.2	Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....	12
2.4.3	Kriteret teknike	12
2.5	Piramida e pyetjeve audituese.....	13
2.5.1	Qasja/metodologjia e auditimit	14
2.5.2	Metodat/teknikat audituese	14
2.6	Rezultatet e parashikuara	14
2.6.1	Impakti për Njësitë e Vetë Qeverisjes Vendore, Kuvendin dhe Qeverinë.....	14
2.6.2	Impakti për publikun dhe palët e interesit.....	14
2.6.3	Forma e publikimit.....	14
3.	Shtjellimi i pyetjeve të piramidës	15
1.1.1	A është mbështetur procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në plane/rregullore për këtë qëllim?.....	15
1.1.2	A është bazuar procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në analiza financiare në përputhje me burimet në dispozicion?	17
1.2.1	A ka kryer BV mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të kontratës?.....	20

1.2.2 A janë zbatuar me përpikmëri detyrimet e kontratës sa i takon largimit të mbetjeve/fshirjes dhe larjes së rrugëve/edukimit publik?	25
4. Trajtimi i observacioneve	33
5. Përmbledhja	34
6. Aneksë.....	37

☞Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrulli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, (<i>The International Organisation of Supreme Audit Institutions</i>)
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të (International Standards of Supreme Audit Institutions)
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
OJF	Organizatë Joqeveritare (Jo-fitimprurëse)
BV	Bashkia Vlorë
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
SKMM	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AK	Autoriteti Kontraktor
OE	Operatori Ekonomik privat që ofron shërbimin e pastrimit

1. Rëndësia e Auditimit

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm.

Pastrimi i qytetit mund të konsiderohet ndër shërbimet më të rëndësishme që garanton një Bashki, në funksion të mirëqenies së qytetarëve. Ndotja në përgjithësi dhe në këtë rast nga mos largimi i mbeturinave apo mungesa e shërbimeve të pastrimit, përbën një rrezik të madh për përhapjen e infeksioneve dhe epidemive. Duke pasur një impakt si social ashtu edhe shëndetësor, si dhe duke marrë parasysh problematikat që rezultuan nga auditimi i mëparshëm i performancës mbi menaxhimin e mbetjeve, rëndësia e auditimit me temë “Pastrimi i qytetit” qëndron në vlerësimin e rezultateve të operacioneve, programeve dhe masave të marra nga Bashkia Vlorë për garantimin e një shërbimi pastrimi sa më efektiv, si dhe ndërgjegjësimin e popullsisë në funksion të përmirësimit të situatës.

1.1 Konteksti i problemit social

Standardet në rritje të jetesës janë shoqëruar nga rritje paralele në prodhimin e mbetjeve e si pasojë në rritje të ndotjes mjedisore. Urbanizimi dhe zhvillimet spontane të territorit në vitet e fundit e kanë vështirësuar garantimin e një shërbimi sa më të plotë dhe efektiv të pastrimit të qytetit¹. Gjenerimi dhe keq menaxhimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore. Shërbimi i pastrimit të mbetjeve urbane, në vetvete përmban disa komponentë:

1. Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit.
2. Garantimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës.
3. Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peizazhit.²

Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve nga Bashkia Vlorë, ky shërbim ka pasur problematikat e veta, për shkak të rritjes së popullsisë së qytetit, shtrirjes territoriale, krijimit të lagjeve të reja, ndërgjegjësimin të ulët të banorëve në hedhjen e mbeturinave, si dhe mos vjeljes plotësisht të tarifës së pastrimit.

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri dhe në Bashkinë Vlorë konkretisht, është në një nivel të ulët. Problemet e gjenerimit të mbetjeve dhe menaxhimit të tyre janë të shumta dhe të ndryshme. Sasitë më të mëdha të gjenerimit të mbetjeve (për nga pesha) janë mbetjet nga materialet inerte, në veçanti nga ndërtime, por rreziku më i madh është i lidhur me gjenerimin e mbetjeve të rrezikshme (kryesisht industriale). Mbetjet bashkiake kanë nevojë për grumbullim, transportim dhe asgjësim të veçantë dhe të kushtueshëm. Hedhjet e paautorizuara janë të zakonshme në tokë dhe në rrjedhat ujore, sidomos pranë vendbanimeve të vogla. Materialet shpesh lihen ose hidhen në mjedis, duke ndotur tokën përreth dhe rrjedhat ujore. Po kështu, është e zakonshme që mbetjet shtëpiake dhe të tjera si këto të digjen në ambient të hapur, duke shkaktuar gazra helmues.³

Garantimi i një shërbimi pastrimi efektiv nënkupton linjën e parë të mbrojtjes ndaj viruseve apo sëmundjeve infektive. Një qytet i pastër nënkupton mirëqenie sociale, ekonomike dhe shëndetësore, duke përmirësuar jetën e qytetarëve, si dhe rritjen e numrit të turistëve. Për këtë arsye, shërbimi i pastrimit duhet të shihet më tepër si një investim se sa një shpenzim.

1.2 Strategjia e KLSH-së në auditimet e performancës

Referuar standardeve ndërkombëtare të auditimit, uditimi i performancës është një “shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të

¹ <http://www.akm.gov.al/assets/raporti-i-gjendjes-ne-mjedis-2018.pdf>.

² Ligji nr. 8094 datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave".

³ Analiza e kostos “Shërbimi i pastrimit në qytet, Bashkia Vlorë”.

saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”. Auditimi i performancës është një metodë moderne nëpërmjet të cilës taksapaguesit, financierët, vendimmarrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll mbi mënyrën e kryerjes së punës dhe arritjen e objektivave nga ana e enteve shtetërore dhe ka si synim të gjenerojë korrigjime apo përmirësime në procese apo procedura për rritjen e mirëqenies sociale përmes aktiviteteve publike.⁴

Në strategjinë 2018 - 2022, puna audituese në departamentin e performancës, krahas çështjeve mikro-ekonomike do të fokusohet edhe në ato makro-ekonomike.

Auditimi i Performancës në KLSH, në 5 vjeçar-in e funksionimit të kësaj strategjie, synon të rritet duke u bërë promotor i zhvillimit institucional dhe duke u konsoliduar në një auditim analitik, këshillues, bashkëpunues e vlerë shtues, duke përcaktuar që numri i auditimeve të performancës të shkojë në 30-35% të punës audituese institucionale.

1.3 Auditime të mëparshme në këtë fushë

Auditimet e performancës që janë kryer nga KLSH në fushën e mjedisit gjatë viteve të fundit, kanë pasur një rritje të konsiderueshme në numër dhe në cilësi. Duke qenë edhe pjesë e EUROSAI dhe INTOSAI Working Group mbi Auditimet e Mjedisit, KLSH ka rritur fokusin e saj për auditimet me perspektivë mjedisore. Disa nga auditimet e performancës të kryera në vite janë:

1. Auditimi i Performancës me temë “*Menaxhimi i përpunimit të mbetjeve të ngurta në impiantin e bashkisë Fier*”, i kryer në vitin 2018. Mesazhi i këtij auditimi ishte: “Në zhvillimin e projektit për incenerimin e mbetjeve urbane për përfitim të energjisë, palët e interesit janë konsultuar në mënyrë formale, si publiku, i cili ka qenë vazhdimisht kundër, dhe institucionet zyrtare lokale të cilat nuk kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe nuk kanë përfaqësuar publikun e tyre, por projekti është vendosur për t’u zhvilluar pavarësisht kësaj situate. Projekti është ngritur dhe po ecën përpara duke krahasuar vetëm 2 alternativa, atë ekzistente pa projekt dhe atë që mund të jetë sipas këtij projekti. Gjatë zgjedhjes së kësaj alternative nuk janë konsideruar alternativa të tjera të mundshme, duke anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, e duke mos zbatuar kësaj Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve”⁵.
2. Auditimi i performancës me temë “*Menaxhimi i Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Tiranës*”, i kryer në vitin 2016, me mesazhin si vijon:
Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi performance, synojnë të kontribuojnë e të ndihmojnë menaxhimin e Bashkisë Tiranë, në përmirësimin e situatës dhe marrjen e masave konkrete, përgatitjen e zbatimit të një strategjie lokale për menaxhimin e mbetjeve të ngurta (si pjesë e Strategjisë Kombëtare të menaxhimit të mbetjeve), duke ndërhyrë në infrastrukturë me vendosjen e konteniervave të rinj bashkëkohorë me objektiv ndarjen në burim, rritjen e nivelit të zhvillimit të metodave të edukimit ambiental, krijimin e një partneriteti më të mire publik privat me operatorët ekonomikë, krijimin e një dokumentacioni të saktë e ligjor për vlerësimin e mbikëqyrjen e punës së OE, përcaktimin e grafikëve të pastrimit, shtimin e vendgrumbullimeve të reja dhe sigurimin e një mjedisi të pastër. Vendosja e kontraktimeve me subjekte private e shtetërore që prodhojnë mbetje të llojeve të ndryshme sipas metodave bashkëkohore, duke detyruar ato të paguajnë për largimin e këtyre mbetjeve sipas rregulloreve në fuqi.
3. Auditimi i performancës me temë: “*Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane në rastin e bashkisë Fier*”, i kryer në vitin 2013, me mesazhin si vijon:
Në Bashkinë Fier menaxhimi i mbetjeve urbane nuk është në nivelin e duhur dhe përmirësimi i punës në drejtim të parandalimit të ndotjes, rritjes së cilësisë së jetës së qytetarëve, efikasitetit të

⁴ Ekonomicitet, Efiçiençë, Efektivitet; ndërkohë që nga zhvillimet e fundit promovohet aplikimi i 6E-ve, së bashku me Energy, Environment, Ethics (Energji, Mjedis, Etikë).

⁵ Vendim Nr. 236 Datë 21.12.2018 http://www.klsh.org.al/web/09_inceneratori_fier_4702.pdf.

përdorimit të burimeve e mbrojtjes së mjedisit, do të sillte minimizimin e ndikimit negativ të mbetjeve nëpërmjet zgjedhjes së opsionit më të mirë të menaxhimit të tyre.

1.4 Subjekti nën auditim

Institucioni subjekt auditimi është **Bashkia Vlorë**, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e programeve/planeve dhe rregulloreve për pastrimin e qytetit, përzgjedhjen e operatorit ekonomik për këtë qëllim, si dhe mbikëqyrjen e realizimit të këtij shërbimi me efektivitet.

1.4.1 Hyrje në subjektet në auditim

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive në procesin e menaxhimit të mbetjeve dhe pastrimit të qytetit janë të përcaktuara në legjislacionin e cituar në rubrikën e kriterëve të auditimit. Bazuar në legjislacionin në fuqi dhe konkretisht Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”, në mënyrë të përmbledhur Bashkia Vlorë ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- Çdo bashki ka si funksion të vetin kryerjen e procesit të grumbullimit, largimit dhe përpunimit të mbetjeve⁶;
- NJQV-të përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e hartuara nga MTM⁷;
- Çdo NJQV apo grup njësisish të qeverisjes vendore harton Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve⁸
- Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit; Garantimin e kërkesave higjieniko-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës; Të ruajë e të mbrojë faunën e florën dhe degradimin e mjedisit e të peizazhit⁹.

1.4.2 Politikat e institucionit/agjencisë

Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar, hulumtimet në faqet web si dhe auditimit të mëparshëm mbi menaxhimin e mbetjeve, rezulton se në nivel politikash është miratuar në vitin 2011 Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, në bazë të të cilit ngarkohen NjQV për hartimin e Planeve Vendore për Menaxhimin e Mbetjeve dhe përcaktimin e objektivave specifike në funksion të këtij procesi. Që në fazën studimore rezultoi se Bashkia Vlorë nuk ka hartuar Plane Vendore për Menaxhimin e Mbetjeve në territorin e saj dhe as nuk u konstatuan objektiva specifike në funksion të përmirësimit të situatës së pastrimit si p.sh mbulimi më i madh i popullsisë me shërbim, rritja e numrit të kontenierëve, ndërgjegjësimi për reduktimin e mbetjeve, etj. Me përjashtim të ofrimit të shërbimit standard të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, si dhe larjes së rrugëve, Bashkia Vlorë nuk ka objektiva të tjera zhvillimore dhe nuk ekzistojnë plane veprimi konkrete për përmirësimin e situatës.

1.4.3 Pesha në buxhet

Buxheti i Bashkisë Vlorë në total dhe në veçanti për pastrimin e qytetit për periudhën 2017-2019 paraqitet si më poshtë:

	2017	2018	Ndryshimi	2019	Ndryshimi

000 lekë

⁶ Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin e qeverisjes vendore”, neni 10.

⁷ Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.


⁸ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 12, pika 2.

⁹ Ligji nr. 8094, datë 21.3.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”.

Të ardhura nga tarifa pastrim/ndriçim/gjellbërim	150.605	257.264	+106,659	281.906	+24,642
Shpenzime pastrimi	448.012	401.815	-46,197	320.990	-80,825
Buxheti total i BV	1.732.323	1.549.526	-182,797	1.718.907	+169,381

Tabela nr. 1 Burimi: Buxhetet e parashikuara me VKB përkatëse për vitet 2017-2019

Nga tabela e mësipërme vihet re se buxheti në dispozicion për shërbimin e pastrimit (grumbullim/largim mbeturinash dhe fshirje/larje rrugësh) përbën 25,8% të buxhetit total të Bashkisë për vitin 2017, 25,9% për vitin 2018, 18,6% dhe për vitin 2019. Pavarësisht se për periudhën objekt auditimi vihet re një ulje e shpenzimeve për zërin pastrim, kjo nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë planifikimi më eficient për këtë shërbim, por nga fakti se për vitet 2018-2019, Bashkia Vlorë nuk ka përfshirë më në llogaritjet e saj për buxhetin territoret Novoselë, Qendër, Shushicë (të parashikuara në buxhetin 2017). Po kështu, për vitin 2019 krahas sa më lart, ka pasur ndryshime edhe në koston e llogaritur për zonën e Orikumit.



Grafiku nr. 1

Krahas peshës në buxhet për zërin pastrim, nga tabela vihet re se shpenzimet për këtë shërbim mbulohen në nivele shumë të ulëta nga tarifa e pastrimit e mbledhur nga subjektet private dhe familjare dhe konkretisht kjo tarifë mbulon vetëm 33,6% të shpenzimeve për vitin 2017, 64% për vitin 2018 dhe 87,8% për vitin 2019.

1.4.4 Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Risqet e aktiviteteve të subjektit nën auditim kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që institucioni has në arritjen e objektivave dhe realizimin e detyrave e funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi. Në këtë auditim, analiza e riskut është mbështetur në identifikimin e risqeve sipas 6 elementëve të analizës PESTLE si më poshtë:

Politike	Ekonomike	Sociale	Teknologjike	Ligjore	Mjedisore (Enviroment)
----------	-----------	---------	--------------	---------	------------------------

Miratimi i vonuar i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.	Mos mbledhja e tarifave të pastrimit në masën 100%;	Lëvizje të shpeshta demografike dhe migrimi i brendshëm informal, si dhe mbi popullimi në sezonin turistik veror.	Amortizimi dhe dëmtimi i kontenierëve;	Hapësirat ligjore në çështjet e prokurimit publik që lejojnë operimin nëpërmjet kontratave shtesë për një kohë të gjatë;	Ndotjet e shkaktuara nga mos mbulimi me shërbim për të gjithë popullsinë;
Mungesa e Planeve Vendore për Menaxhimin e Mbetjeve;	Mos llogaritja e kostove të shërbimit të pastrimit sipas një metodologjie të caktuar, apo sipas një modeli të gabuar.		Mundësia e dëmtimeve të pajisjeve teknologjike të OE.	Mungesa e rregulloreve Higjeno-sanitare dhe e Rregulloreve për Shërbimin e pastrimit publik.	Ndotje si pasojë e pa mundësisë së mjeteve të mbledhjes së mbeturinave për të aksesuar rrugë/hapësira të zëna nga ndërtimet apo parkimet pa kriter.
Mungesa e objektivave konkrete për zhvillimin apo përmirësimin e mëtejshëm në çështjet e pastrimit të qytetit.				Mungesa e rregulloreve të monitorimit të shërbimit.	

Tabela nr. 2

1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

Produktet e subjektit nën auditim lidhen me qëllimin final garantimin e një qyteti të pastër, si dhe mirëqenien e banorëve nëpërmjet masave dhe veprimeve si vijon:

- ✓ Garantimi i hapësirave dhe kontenierëve të nevojshëm për depozitimin e mbetjeve, si dhe grumbullimi dhe transportimi i tyre për të vijuar procesin e menaxhimit të mbetjeve;
- ✓ Larja dhe lagia e rrugëve dhe shesheve;
- ✓ Sistemimi i kontenierëve dhe mbetjeve;
- ✓ Mbikëqyrja e procesit të zbatimit të kontratës;
- ✓ Edukimi publik në funksion të ndërgjegjësimit të popullsisë për reduktimin e mbetjeve dhe depozitimin e tyre në pikat e caktuara dhe brenda kontenierëve të vënë në dispozicion për këtë qëllim.

Të gjitha këto masa apo veprime, duhet të mbështeten në Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Rregulloreve higjeno-sanitare dhe të shërbimit të pastrimit publik, të hartuara nga NJQV, të cilat përbëjnë bazën e procesit të planifikimit të shërbimit dhe më tej të mbikëqyrjes së tij.

1.4.6 Feedback-u i subjektit

Lidhur me fazën studimore, Bashkia Vlorë nuk i është përgjigjur shkresës për konfirmimin e takimit prezantues brenda afateve, megjithatë bashkëpunimi në vijim ka qenë korrekt duke vënë në dispozicion dokumentacionin dhe informacionet që dispononte brenda afateve të kërkuara. Megjithatë, nuk vlen e njëjta gjë për fazën e terrenit, gjatë të cilës subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë, apo të miratuar, duke shkaktuar vonesa në vënien në dispozicion të tyre pas disa kërkesash.

2. Qasja dhe detajet e auditimit

2.1 Objektivi dhe problemi

Auditimi i performancës me temë “*Shërbimi i pastrimit të qytetit*” në Bashkinë Vlorë synon të ofrojë një panoramë të qartë mbi nivelin e efektivitetit në ofrimin e shërbimit të pastrimit të qytetit të Vlorës. Auditimi do të fokusohet në masat dhe veprimet e ndërmarra nga Bashkia Vlorë sa i takon procesit të planifikimit dhe mbikëqyrjes së procesit të pastrimit të qytetit, si dhe edukimit publik mbi rolin e tyre në mbajtjen pastër të qytetit dhe reduktimin e mbetjeve.

2.2 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit

Në funksion të përmbushjes së detyrave të saj lidhur me pastrimin e qytetit, Bashkia Vlorë ndërmerr veprimet si më poshtë:

- Grumbullimi dhe largimi i sasive të mbetjeve, fshirja dhe larja e rrugëve sipas volumeve të përcaktuara në kontratën 5 vjeçare dhe grafikëve për këtë qëllim, si dhe sistemimi i kontenierëve dhe mbetjeve në vend depozitim;
- Monitorimi për zbatimin me rigorozitet të kontratës;
- Edukimi publik për të rritur dhe përmirësuar njohuritë e konsumatorëve, të kontraktuesit dhe banorëve të qytetit në lidhje me largimin e mbetjeve, mbledhjen dhe hedhjen, apo aspekte të tjera të administrimit të tyre.

Në mungesë të objektivave specifike në funksion të përmirësimit të situatës dhe bazuar në risqet e evidentuara gjatë fazës studimore për përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe pas konsultimit të modeleve Finlandeze dhe Holandeze të përcaktimit të objektivave për këtë qëllim, grupi i auditimit u fokusua në vlerësimin e elementëve që impaktojnë garantimin efektiv të këtij shërbimi si më poshtë:

- Procesi i planifikimit për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të situatës së mbetjeve apo pastërtisë së qytetit;
- Analizimin e kostove të shërbimit dhe masat e marra për mbledhjen 100% të tarifës së pastrimit;
- Hartimi dhe zbatimi i rregulloreve higjeno-sanitare apo të shërbimit të pastrimit publik;
- Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës së shërbimit.

2.3 Përkufizimet dhe terminologjia

1. "*Mbeturina*" janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerëzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.
2. "*Largimi publik i mbeturinave*" quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbeturinave.
3. "*Grumbullimi i mbeturinave*" quhet procesi i pranimit të mbetjeve në vende të caktuara.
4. "*Vendi i grumbullimit*" të mbeturinave është sipërfaqe toke e caktuar nga pushteti lokal për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.
5. "*Zonë e kontratës*" quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhë, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të plehrave ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe gjithë konsumatorët që mund të shtohen gjatë kohështrirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë.
6. "*Zonë e lagies*" quhet shërbimi i lagies së rrugëve, pa trotualet e rrugëve.
7. "*Edukimi publik*" quhet përpjekja për të rritur a përmirësuar njohuritë e konsumatorëve, të kontraktuesit a banorëve të qytetit në lidhje me largimin e plehrave, mbledhjen dhe hedhjen ose çdo aspekt tjetër të administrimit të tyre.
8. "*Menaxhim i Integruar i Mbetjeve*" është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

9. “Transportim” është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mjetet.

2.4 Kriteret

2.4.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim SKZHI 2015 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve.

2.4.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raportet e gjendjes në mjedis 2017-2019;
- Artikuj nga media e shkruar dhe elektronike;
- Rregullore e brendshme e Bashkisë Vlorë/Detyrimet dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësit të shërbimit të pastrimit;
- Kontrata me OE për periudhën nën auditim/ Detyrimet dhe përgjegjësitë e mbikëqyrësit të kontratës.

2.4.3 Kriteret teknike

- Ligj nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 10;
- Ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligj nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 12;
- Ligji nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për Largimin Publik të Mbeturinave”;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, neni 22;
- VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”;
- VKB nr. 44, datë 28.12.2015 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”;
- VKB nr. 100, datë 22.12.2017 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”;
- VKB nr. 109, datë 27.11.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”;
- Rregullore e Brendshme Bashkia Vlorë.

2.5 Piramida e pyetjeve audituese

A ka ofruar Bashkia Vlorë një shërbim efektiv të pastrimit të qytetit për periudhën 2017-2019?

1.1 A ka kryer BV një planifikim eficient për mbulimin e pastrimit të qytetit?

1.1.1 A është mbështetur procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në plane/rregullore për këtë qëllim?

1.1.2 A është bazuar procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në analiza financiare në përputhje me burimet në dispozicion?

1.2 A ka sjellë rezultate pozitive zbatimi i kontratës në funksion të garantimit të një qyteti të pastër?

1.2.1 A ka kryer BV mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të kontratës?

1.2.2 A janë zbatuar me përpikmëri detyrimet e kontratës sa i takon largimit të mbetjeve/fshirjes dhe larjes së rrugëve/edukimit publik?

2.5.1 Qasja/metodologjia e auditimit

Për të vendosur mbi qasjen që do të ndiqet në këtë auditim, jemi bazuar në të dhënat e grumbulluara, komunikimet me institucionet e përfshira në planifikimin dhe zbatimin e masave të nevojshme për garantimin e shërbimit të pastrimit të qytetit të Vlorës, si dhe rregulloret e funksionimit të Bashkisë së këtij qyteti. Nisur nga fakti se grupi i auditimit është fokusuar kundrejt shqyrtimit të efektivitetit të veprimeve të ndërmarra dhe realizimit të objektivave nga institucioni i sipërpërmendur, qasja audituese do të jetë e orientuar kah rezultatit, duke analizuar dhe konkluduar mbi punën e kryer, për periudhën 2017 - 2019. Për të arritur në konkluzione dhe rekomandime, puna audituese do të përmbajë elementë analitikë dhe krahasues.

2.5.2 Metodatat/teknikat audituese

Metodat e përdorura janë si vijon:

- Studim gjithëpërfshirës i kuadrit rregullator vendas dhe të huaj, rregulloreve, manualeve dhe kriterëve e praktikave të tjera më të mira;
- Analizë cilësore dhe sasiore e të dhënave të përfituara nga subjektet nën auditim;
- Mbledhje, shqyrtim dhe analizim i dokumentacionit të auditimit;
- Takime dhe intervista me drejtues dhe stafin e institucioneve të përfshira në auditim, si dhe me OJF të përfshira në këtë çështje dhe përpunimi dhe analizimi i përgjigjeve të tyre;
- Vizita në terren, për të parë më konkretisht aktivitetet dhe problematikat që hasen në çështjen në fokus;
- Hartimi i pyetësorëve me shkrim për palët e përfshira dhe analizimi i përgjigjeve të tyre;
- Vlerësimi dhe analizimi i feedback-ut të marrë për të arritur në konkluzione.

2.6 Rezultatet e parashikuara

2.6.1 Impakti për Njësitë e Vetë Qeverisjes Vendore, Kuvendin dhe Qeverinë

Nëpërmjet auditimit, palët do të njihen me situatën aktuale dhe progresin e bërë në drejtim të shërbimit të pastrimit të qytetit, si dhe me problematikat që shtrohen në këtë proces. Rezultatet e këtij auditimi do të ndihmojnë në informimin e Kuvendit dhe Qeverisë mbi punën e bërë nga pushteti lokal dhe konkretisht Bashkia Vlorë për garantimin e një qyteti sa më të pastër. Nëpërmjet rekomandimeve të lëna, institucionet e sipërpërmendura do të kenë mundësinë të ndërhyjnë nëpërmjet rritjes së kërkesës së llogarisë ndaj pushtetit lokal, apo nëpërmjet hartimit të strategjive kombëtare të nevojshme për përmirësimin e punës së Bashkive nga këndvështrimi i planifikimit strategjik, apo ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin e situatës, duke promovuar shërbime të kënaqshme e sipas standardeve bashkëkohore.

2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit

Ky auditim synon të njohë publikun me detyrimet që ka pushteti lokal në funksion të garantimit të mirëqenies sociale, ekonomike dhe shëndetësore të tyre, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit të qytetit, si dhe me masat e nevojshme që ndërmerren për këtë qëllim. Nëpërmjet raportit të auditimit, publiku dhe palët e interesit do të informohen mbi veprimet e ndërmarra nga Bashkia Vlorë për garantimin e një qyteti të pastër, mbi nivelin e efektivitetit të këtij shërbimi, si dhe me vështirësitë dhe problematikat që ato hasin gjatë këtij procesi. Në këtë mënyrë ky raport do të shërbejë edhe si një mundësi ndërgjegjësimi për publikun dhe palët e interesit për rolin dhe detyrimet që ata kanë në mbajtjen pastër të qytetit.

2.6.3 Forma e publikimit

Në përfundim të auditimit u përgatit Projekt-Raporti i Auditimit, i cili i'u dërgua Bashkisë Vlorë. Në përfundim të afatit për paraqitjen nga Bashkia Vlorë të komenteve dhe vërejtjeve mbi projekt raportin, ky institucion nuk paraqiti asnjë të tillë. Në vijim, grupi i auditimit përgatiti Raportin Final

të Auditimit, i cili do ti përcillet përsëri subjektit dhe do publikohet në faqen web të KLSH-së, apo dhe workshop - e të ndryshme dhe analiza vjetore të institucionit.

3. Shtjellimi i pyetjeve të piramidës

A ka ofruar Bashkia Vlorë një shërbim efektiv të pastrimit të qytetit për periudhën 2017-2019?

Mesazhi i auditimit:

Shërbimi i pastrimit të qytetit ka rezultuar pjesërisht efektiv. Mangësi vërehen në procesin e planifikimit, kryesisht atë financiar, ku Bashkia Vlorë shpenzon një vlerë të konsiderueshme për pastrimin e qytetit, e cila nuk mbulohet dot nga të ardhurat e mbledhura për pastrimin. Po kështu, kontrata e lidhur mes palëve nuk është zbatuar me rigorozitet pasi ka shumë elementë të përcaktuar në të, të cilët janë neglizhuar dhe gjithashtu ka mungesë transparence në garantimin e përmbushjes së çdo zëri të kontratës. Me gjithë përpjekjet e deri tanishme, vëmendja duhet të jetë më e madhe drejt ndërmarrjes së studimeve dhe planifikimit të shërbimeve në proporcion me burimet financiare në dispozicion të Bashkisë, si dhe kërkesës së shtuar të llogarisë ndaj operatorëve ekonomik.

1.1.1 A është mbështetur procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në plane/rregullore për këtë qëllim?

Që një shërbim të rezultojë efektiv në tërësi, nevojitet të kryhet një proces eficient planifikimi duke marrë parasysh burimet në dispozicion të njësisë ekonomike, si dhe të zbatohet me rigorozitet kontrata për këtë qëllim. Një proces planifikimi i mirë menduar duhet të mbështetet në ligje, rregullore e standarde të hartuara e miratuara për fushat përkatëse. Në nenin 9 të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave” përcaktohet se metodat dhe teknologjitë për largimin e mbeturinave hartohen nga bashkitë në bashkëpunim me organet kompetente, bazuar në rregulloren për shërbimin e pastrimit publik. Në këtë rast, Bashkia Vlorë si organi kompetent për zbatimin e kësaj dispozite, duhet të kishte hartuar dhe miratuar, së pari rregulloren për shërbimin e pastrimit publik dhe në vijim të saj edhe metodat dhe teknologjitë e nevojshme për këtë shërbim. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Vlorë nuk ka hartuar rregulloren për shërbimin e pastrimit publik dhe as metodat dhe teknologjitë për largimin e mbetjeve. Nga përgjigjet e pyetësorëve, përfaqësuesit e subjektit pohuan se këto metoda dhe teknologji bëhen pjesë të termave të referencës gjatë përgatitjes së procedurës së prokurimit, ndërkohë që ato duhet të jenë dokumente të hartuara më parë nga Bashkia Vlorë dhe jo në funksion të një kontrate specifike. Megjithatë edhe pas kërkesës së grupit të auditimit për vënien në dispozicion të termave të referencës për këtë shërbim, këto metoda dhe teknologji nuk rezultuan të ishin pjesë e termave të referencës. BV nuk mund të përcaktojë metodat dhe teknologjitë vetëm në momentin e lidhjes së një kontrate, pasi këto dokumente duhet të jenë baza dhe mbështetje për procesin e planifikimit të shërbimit të pastrimit të qytetit.

Në nenin 22 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, përcaktohet se autoritet e qeverisjes vendore duhet të përgatisin plane veprimi dhe vendore për mjedisin, në mënyrë periodike. Po kështu, disa njësi vendore kanë hartuar edhe plane veprimi për menaxhimin dhe monitorimin e tregueseve të performancës për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të pastrimit. Nga auditimi rezultoi se Bashkia Vlorë nuk ka marrë masa për hartimin dhe vënien në zbatim të asnjë prej planeve vendore të sipër cituara. Krahas mungesës së këtyre dokumenteve që përcaktojnë prioritetet dhe fokusin e njësisë vendore në ofrimin e një shërbimi efektiv, u konstatua gjithashtu se BV nuk ka miratuar as objektiva specifike në funksion të përmirësimit të situatës si p.sh mbulimi më i plotë i popullsisë me shërbim, rritja e numrit të kontenierëve, ndërgjegjësimi, etj. Në mungesë të këtyre elementëve, është e pa qartë dhe jo transparente kuadri rregullator ku Bashkia Vlorë mbështet planifikimin e një shërbimi kaq të rëndësishëm dhe as synimet e saj në përmirësimin e situatës në të ardhmen. Një tjetër element që vërteton mangësitë në procesin e planifikimit të shërbimit, është edhe

mungesa e vlerësimit të volumeve nëpërmjet matjes me peshë, për të matur rregullisht çdo ditë volumin e mbetjeve të gjeneruara. Si pasojë e mungesë së peshores, gjatë planifikimit të nevojave, Bashkia Vlorë merr të mirëqenë një sasi fikse mbetjesh çdo vit. Në mungesë të planeve të veprimit apo objektivave konkrete, si dhe mos përcaktimit dhe analizimit të treguesve të performancës të tillë si niveli i mbulimit të popullsisë me shërbim, apo niveli i përmbushjes së detyrimeve të kontratës, Bashkia Vlorë prej 15 vitesh përllëgarit të njëjtin volum mbetjesh prej 140 ton/ditë, duke marrë parasysh këtu se për periudhën nën auditim, numri i popullsisë dhe subjekteve private në këtë qytet është shtuar¹⁰. Detyrimi që NjQV-të kanë për hartimin e planeve vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që kanë në juridiksion, sanksionohen edhe në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011, për “Menaxhimin e integruar të mbetjeve”, por BV vazhdon të mos zbatojë kërkesat ligjore edhe pse këto kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme nga legjislacioni.

Kontrata e audituar nuk disponon gjithashtu as indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit të pastrimit. Pavarësisht se në akt kontrolle mbikëqyrësi shprehet se punimet janë kryer me cilësi, ky rezultat nuk bazohet në indikatorë të matshëm, por është thjeshtë një gjykim personal i mbikëqyrësit të shërbimit të pastrimit.

Referuar Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë, mbikëqyrësi i shërbimit të pastrimit duhet të kontrollojë kryerjen e të gjitha proceseve të pastrimit, frekuencën e tyre dhe cilësinë e pastrimit, si dhe gjendjen dhe pastrimin e mjeteve të përdorura për këtë qëllim, bazuar në rregulloren higjieno-sanitare, e cila nuk është hartuar nga BV. Nga përgjigjet e pyetësorit të subjektit rezulton se: -“kërkesat higjieno-sanitare dhe ekologjike që duhet të respektojnë mjetet e transportit të mbetjeve është larja në lavazh çdo ditë pas punës dhe makinat teknologjike kur fillojnë punën për largimin e mbeturinave duhet të jenë të lara”. Duke qenë se lloji i shërbimit ku operojnë këto mjete rezulton me nivele tepër të larta ndotje, kërkesat higjieno-sanitare dhe ekologjike nuk mund të kufizohen vetëm në larjen në lavazh të tyre dhe aplikimi i kësaj procedure është i pa mjaftueshëm.

Po kështu, u konstatua se Bashkia Vlorë nuk e mbështet punën e saj dhe as procesin e planifikimit në standarde, udhëzues apo dokumente të tjera të ngjashme të cilat të jenë hartuar nga ekspertë të fushës dhe të orientojnë shërbimin drejt elementëve të mirë studiuar për këtë shërbim. Mungesa e këtyre dokumenteve orientues sjell mangësi në procesin e vlerësimit të cilësisë së këtij shërbimi.

Gjetje:

- ✓ Në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, nenin 22 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Vlorë, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në Bashki nuk ka hartuar dhe miratuar:
 - a) metodat dhe teknologjitë për largimin e mbeturinave;
 - b) planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
 - c) rregulloren e shërbimit të pastrimit publik;
 - d) rregulloren higjieno-sanitare dhe ekologjike;
 - e) tregues të performancës së shërbimit dhe indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit; dhe
 - f) objektiva specifike për shërbimin e pastrimit dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

Konkluzion:

- ✓ Bashkia Vlorë ka neglizhuar në hartimin e kuadrit rregullator bazë sa i takon orientimit për kryerjen e shërbimit të pastrimit. I gjithë procesi i planifikimit nuk mbështetet në metodologji për largimin e mbetjeve dhe nuk i referohet asnjë udhëzuesi apo standardi për këtë qëllim. Mungesa e këtyre dokumenteve orientues sjell mangësi edhe në procesin e vlerësimit të cilësisë së këtij shërbimi.

¹⁰ Parashikimi i bërë në VKB vit pas viti, gjatë hartimit të buxhetit të Bashkisë dhe konkretisht gjatë parashikimit të të ardhurave nga tarifa e “pastrim,gjellbërim,ndriçim”

Rekomandim:

- ✓ Bashkia Vlorë dhe Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, në bashkëpunim me ekspertë të fushës të marrë masa për hartimin dhe miratimin e metodologjive dhe rregulloreve të munguara prej kohësh, ku të përshkruhen qartë çdo element që lidhet me këtë shërbim dhe parametra/standarde të cilat duhet të aplikohen;

Dhjetor 2021

1.1.2 A është bazuar procesi i planifikimit të shërbimit të pastrimit në analiza financiare në përputhje me burimet në dispozicion?

Bashkia Vlorë kryen veprimtarinë e saj mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ku organet e pushtetit vendor ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me parimin e autonomisë. Referuar këtij parimi, NjVQV kanë të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve për përmbushjen e funksioneve të tyre. Po kështu, referuar Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", burimet financiare të tyre duhet të shpërndahen në përputhje me prioritetet strategjike dhe nevojat e komuniteteve. Për sa më lart, Bashkia Vlorë vendos taksat dhe tarifën vendore dhe në këtë rast tarifën vendore për shërbimin "pastrim, gjelbërim, ndriçim" në një zë të vetëm. Referuar Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 "Për largimin publik të mbeturinave", Bashkitë duhet të përcaktojnë tarifën e pastrimit duke pasur parasysh teknikën dhe teknologjinë e përdorur, koston, numrin e kontenerëve dhe kushte të tjera. Nga auditimi u konstatua se, në Vendimet e Këshillit Bashkiak nuk bëhet transparente metodologjia e përlllogaritje të tarifës së pastrimit, apo elementët që janë marrë parasysh për të arritur në vlerën përfundimtare të tarifës. Krahas këtij konstatimi, rezultoi gjithashtu se në asnjë rast për periudhën objekt auditimi, BV nuk mbledh 100% të tarifës. Referuar ligjit të sipërcituar, shpenzimet për largimin publik të mbeturinave dhe shpenzimet e tjera që përdoren për këtë qëllim, mbulohen nga taksat e mbledhura për kryerjen e shërbimit të pastrimit dhe pjesërisht nga buxheti i shtetit. Për sa më lart, rezulton se përveç mos mbledhjes plotësisht të tarifës "pastrim, gjelbërim, ndriçim" edhe vlera e mbledhur për këto tre shërbime nuk mbulon plotësisht as shërbimin e pastrimit. Konkretisht, performanca financiare lidhur me të ardhurat e BV dhe shpenzimit për shërbimin e pastrimit analizohen si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi BV ka miratuar VKB nr. 44, datë 28.12.2015 dhe VKB nr. 100, datë 22.12.2017, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë", dhe është parashikuar që tarifa për "ndriçim, pastrim, gjelbërim" do të jetë:

- Për subjektet tatimpaguese me xhiro 0 deri në 8 milionë lekë, 5.000 -15.000 lekë/ vit;
- Për tregtarët që ushtrojnë aktivitet në tregje të miratuara, 1.200 lekë/muaj;
- Për subjektet tatimpagues me xhiro mbi 8,01 milion lekë, 5.000 – 100.000 lekë/vit;
- Për subjekte kategori të tjera, 5.000 – 80.000 lekë në vit; dhe
- Për familje, 1.800 lekë/vit.

Siç u përmend edhe më lart, për vitin 2017 është mbledhur 77% e tarifës, për vitin 2018 është mbledhur 87% e tarifës dhe për vitin 2019 është mbledhur 86% e tarifës.

Nga planifikimi buxhetor për periudhën objekt auditimi rezulton¹¹:

Për vitin 2017:

- Të ardhurat nga tarifa për "pastrim, ndriçim, gjelbërim" përbëjnë 62% të të ardhurave nga tarifat vendore dhe 6% të të ardhurave totale të Bashkisë.
- Ndërkohë vlera e shpenzimeve për shërbimin e pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës, zë 8.5% të të ardhurave totale të BV. Theksojmë këtu se për të gjitha kontratat e pastrimit në fuqi (duke përfshirë edhe vlerat e kontratave për Orikumin, Novoselë, etj.), kjo peshë shkon në 17%;

¹¹ Buxhetet për vitet 2017-2019

- **Po kështu, vlera e kontratës së pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës zë 91% të të ardhurave nga të gjitha tarifat vendore, ndërkohë që tejkalon në masën 147% të ardhurat nga tarifa për “pastrim, gjelbërim, ndriçim”.** Për këtë rast përmendim se tarifat vendore përbëhen nga 7 zëra, nga ku rezulton se Bashkia Vlorë përdor 91% të vlerës së tarifave vendore për një zë (pastrimi vetëm brenda qytetit) dhe 9% të kësaj vlere për 6 zërat e mbetur.

Për vitin 2018:

- Të ardhurat nga tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” përbëjnë 59% të të ardhurave nga tarifat vendore dhe 7.6% të të ardhurave totale të Bashkisë.
- Ndërkohë vlera e shpenzimeve për shërbimin e pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës zë 11% të të ardhurave totale të BV. Theksojmë këtu se për të gjitha kontratat e pastrimit në fuqi (duke përfshirë edhe vlerat e kontratave për Orikumin, Novoselë, etj.), kjo peshë shkon në 20%;
- **Po kështu, vlera e kontratës së pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës zë 86% të të ardhurave nga të gjitha tarifat vendore, ndërkohë që tejkalon në masën 145% të ardhurat nga tarifa për “pastrim, gjelbërim, ndriçim”.** Përsëri për këtë rast tarifat vendore përbëhen nga 7 zëra, nga ku rezulton se BV përdor 86% të vlerës së tarifave vendore për një zë (pastrimi vetëm brenda qytetit) dhe 14% të kësaj vlere për 6 zërat e mbetur.

Për vitin 2019:

- Të ardhurat nga tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” përbëjnë 55% të të ardhurave nga tarifat vendore dhe 7% të të ardhurave totale të Bashkisë.
- Ndërkohë vlera e shpenzimeve për shërbimin e pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës zë 10% të të ardhurave totale të BV. Theksojmë këtu se për të gjitha kontratat e pastrimit në fuqi (duke përfshirë edhe vlerat e kontratave për Orikumin, Novoselë, etj.), kjo peshë shkon në 15%;
- **Po kështu, vlera e kontratës së pastrimit vetëm për qytetin e Vlorës zë 78% të të ardhurave nga të gjitha tarifat vendore, ndërkohë që tejkalon në masën 143% të ardhurat nga tarifa për “pastrim, gjelbërim, ndriçim”.** Përsëri për këtë rast tarifat vendore përbëhen nga 7 zëra, nga ku rezulton se BV përdor 78% të vlerës së tarifave vendore për një zë (pastrimi vetëm brenda qytetit) dhe 22% të kësaj vlere për 6 zërat e mbetur.

Nga analizimi i të dhënave të mësipërme rezulton se, për asnjë vit tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” nuk mbulon as kontratën e pastrimit brenda qytetit dhe jo më të tre zërat që përfshihen në këtë tarifë (ndriçim, gjelbërim), madje tejkalimi është në vlera të konsiderueshme. Ky fakt vlen po njësoj edhe në rast se tarifa do të mblidhej 100%. Po kështu, për të tre vitet objekt auditimi rezulton se vetëm për pastrimin brenda qytetit do përdoret rreth $\frac{3}{4}$ e totalit të tarifave vendore, ndërkohë për zërat e mbetur vetëm $\frac{1}{4}$. Edhe krahasuar me të ardhurat totale të Bashkisë, përsëri shpenzimet vetëm për pastrimin brenda qytetit zënë mesatarisht 10% të të gjithë të ardhurave të Bashkisë, duke pasur parasysh këtu gamën shumë të gjerë të shërbimeve apo shpenzimeve të tjera që mbulojnë Bashkitë. Në mënyrë të përmbledhur, vihet re se shpenzimet vetëm për pastrimin brenda qytetit janë jashtë mundësive dhe burimeve financiare të Bashkisë.

Lidhur me përllogaritjen e kostove të shërbimit, Bashkia Vlorë ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të kontratës bazuar në metodologji të caktuara për parashikimin, analizimin dhe përllogaritjen e kostos. Lidhur me këtë proces grupi i auditimit kërkoi metodat e përdorura për analizimin dhe përllogaritjen e kostove për këtë shërbim, por nga BV nuk u vu në dispozicion asnjë dokument apo udhëzues i tillë me sqarimin se përfaqësues përgjegjës për shërbimet publike në Bashkinë Vlorë, vite më parë kishin kryer trajnime mbi metodologjitë për llogaritjen e kostove për këto shërbime, por për shkak të periudhës së hershme të zhvillimit të këtij trajnimit, mbikëqyrësi i kontratës së shërbimit të pastrimit dhe Bashkia Vlorë nuk dispononin dokumentacionin e gjeneruar nga ky trajnim. Gjithashtu, në cilësinë e analizës së kostove për këtë shërbim, mbikëqyrësi i kontratës vuri në dispozicion një dokument me këtë titull, por të pa miratuar edhe pse u kërkua disa herë nga grupi i auditimit versioni i miratuar i këtij dokumenti. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti u vu re se në të vërtetë, përmbajtja e tij

ishite përllogaritje e fondit limit që përgatit njësia e prokurimit për procedurën e tenderimit të shërbimit. Pavarësisht se në hyrje të këtij dokumenti përcaktohet se përllogaritja e fondit të nevojshëm do të bazohet në trendet e rritjes demografike të popullsisë së qytetit, shtrirjes territoriale, krijimin e lagjeve të reja, ndërgjegjësimin e ulët të banorëve në hedhjen e mbeturinave, si dhe niveli i ulët i vjeljes së tarifës së pastrimit, në asnjë rast gjatë përllogaritjeve nuk u evidentuan këto elementë. Për më tepër, **u konstatua se përllogaritja e fondit limit bazohej në eksperiencën 15 vjeçare për këtë shërbim, për të cilën operatori fitues ka qenë vazhdimisht i njëjti**, duke mos marrë parasysh një studim tregu, me tregues të krahasueshëm, të saktë dhe që përshtaten me periudhën dhe karakteristikat në ndryshim, të cilat u përmendën më lart. Në përllogaritjen e këtij fondi janë përfshirë vetëm shpenzime operative si paga dhe kontribute të punonjësve të pastrimit, dezinfektant, vegla pune, ujë, pjesë këmbimi automjetesh dhe kontenierësh, karburant, goma dhe vajra për automjetet, rroba pune, antidote, shpenzime materiale (karro, lopata, fshesa), veshmbathje, etj.

Po kështu, u konstatua se për automjetet është parashikuar zëvendësimi rregullisht çdo vit i gomave dhe nuk janë përmendur normat e konsumit për secilin lloj automjeti. Në këtë përllogaritje deklarohet se në çmimin e shërbimit do të përfshihet edhe shërbimi i larjes së automjeteve, vlerë e cila do të përcaktohet në kontratë. Megjithatë ky përcaktim nuk përmendet në kontratë. Përllogaritja e fondit të nevojshëm për këtë shërbim është kryer duke përkthyer të gjithë vlerat e elementëve të sipër cituar në kosto/kontenier, ndërkohë që për shkak të mungesës së peshores, Bashkia Vlorë nuk ka asnjë informacion mbi sasinë e mbetjeve që prodhon në një ditë, element i cili është thelbësor dhe më kryesori në përllogaritjen e kostove për këtë qëllim. Planifikimi për shërbimin e ngarkimit dhe largimit të mbetjeve bëhet prej vitesh për një sasi fikse prej 140 ton mbetje/ditë, si në sezonin e mbi populluar të verës, ashtu dhe gjatë sezonit të zbrazët të dimrit. Duke mos pasur të dhëna mbi sasinë ditore të mbetjeve të gjeneruara, është e pamundur të kryhet një përllogaritje e drejtë dhe reale mbi nevojën për numër kontenierësh dhe më tej për nxjerrjen e kostove/kontenier. Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se BV nuk kryen një planifikim financiar eficient të bazuar në të dhëna të sakta dhe koherente mbi elementët që duhet të mbahen parasysh gjatë një planifikimi të tillë. Konkretisht, BV nuk ka marrë në vlerësim gjatë këtij planifikimi as shtimin e numrit të popullsisë dhe bizneseve të reja, as krijimin e lagjeve të reja dhe as nivelin e vjeljes së tarifave, elementë të cilët kanë shumë impakt në këtë lloj shërbimi, por është përqendruar vetëm në shpenzimet operative për këtë shërbim.

Gjetje:

- ✓ Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme dhe parimin e transparencës, Bashkia Vlorë nuk mbështet përllogaritjen e tarifës së pastrimit në metodologji përllogaritjeje dhe as nuk bën publike analizën e ndjekur për gjenerimin e vlerës përfundimtare të kësaj tarife;
- ✓ Në asnjë rast për periudhën objekt auditimi, Bashkia Vlorë nuk ka mbledhur 100% të tarifës së “pastrim, gjelbërim, ndriçim”;
- ✓ Në kundërshtim me Kreun VI të Ligjit nr. 8094, datë 01.03.1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, të ardhurat nga vjelja e tarifës për “pastrim, gjelbërim, ndriçim” nuk mbulojnë as shërbimin e pastrimit brenda qytetit, ku mesatarisht ky shërbim është në vlerën e 145% të tarifës përkatëse;
- ✓ Mesatarisht për periudhën objekt auditimi, të ardhurat nga tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” përbëjnë 6.9% të të ardhurave totale të Bashkisë (duke marrë parasysh se kjo tarifë mbulon tre shërbime), ndërkohë që shpenzimi për shërbimin e pastrimit vetëm brenda qytetit zë 9.8% të të ardhurave totale të BV;
- ✓ Në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe eficiencës, përllogaritja e fondit të nevojshëm për shërbimin e pastrimit bazohet në eksperiencën 15 vjeçare që Bashkia ka pasur për këtë për këtë shërbim, si dhe duke përfshirë vetëm kostot operative të shërbimit;
- ✓ Për automjetet në funksion të shërbimit është parashikuar zëvendësimi rregullisht çdo vit i gomave dhe nuk janë përmendur normat e konsumit për secilin lloj automjeti;

- ✓ Për shkak të mungesës së peshores, Bashkia Vlorë nuk ka asnjë informacion mbi sasinë e mbetjeve që prodhon në një ditë.

Konkluzione:

- ✓ Burimet financiare të Bashkisë Vlorë nuk janë shpërndarë sipas prioriteteve strategjike të saj, duke shpenzuar për pastrimin vetëm brenda qytetit një shumë të konsiderueshme krahasuar me nivelin e të ardhurave dhe mundësive të saj financiare. Në këtë kontekst edhe planifikimi për këtë shërbim, nuk ka rezultuar eficient duke mos mbajtur parasysh burimet në dispozicion;
- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve nuk kryen një planifikim financiar eficient të bazuar në të dhëna të sakta dhe koherente mbi elementët që duhet të mbahen parasysh gjatë një planifikimi të tillë. Konkretisht, nuk janë marrë në vlerësim gjatë këtij planifikimi as shtimi i numrit të popullsisë dhe bizneseve të reja, as krijimi i lagjeve të reja dhe as niveli i vjeljes së tarifave, elementë të cilët kanë shumë impakt në këtë lloj shërbimi, por është përqendruar vetëm në shpenzimet operative për këtë shërbim.

Rekomandime:

- ✓ Bashkia Vlorë nëpërmjet Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për kryerjen e analizave të kostos së shërbimeve mbështetur në udhëzues apo metodologji të caktuara për këtë qëllim, si dhe të mbajë parasysh elementët e kostos të përcaktuar në VKM nr. 319 datë 31/05/2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Njëkohësisht, të merren masa për mbledhjen e vlerës së plotë të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

Në hartimin e kontratave të ardhshme

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për identifikimin e saktë të volumeve të mbetjeve që gjenerohen dhe të përdorë këto të dhëna gjatë planifikimeve financiare që kryen.

Dhjetor 2021

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për llogaritjen e kostos së shërbimit së pari jo në vlera të konsiderueshme mbi mundësitë e saj financiare dhe së dyti duke bërë pjesë të këtyre përlllogaritjeve elementët thelbësor që janë pjesë e shërbimit të pastrimit si rritja e popullsisë, shtimi i bizneseve, flukset e sezoneve, etj.

Në hartimin e kontratave të ardhshme

1.2.1 A ka kryer BV mbikëqyrjen e duhur të zbatimit të kontratës?

Detyrimet e mbikëqyrësit të kontratës përcaktohen në Ligjin nr. 8094, datë 21.03.996 “Për largimin publik të mbeturinave”, në Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Bashkisë Vlorë, si dhe në kontratën e lidhur mes palëve për shërbimin e pastrimit.

Konkretisht, nenet 14 dhe 22 të ligjit për largimin e mbetjeve përkatësisht përcaktojnë se:

- Bashkia e qytetit dhe komuna kanë të drejtë të kontrollojnë e mbikëqyrin për zbatimin e largimit të mbeturinave, në përputhje me kushtet tekniko-higjienike, në zbatim të kontratës, nga personat e autorizuar prej saj;
- Organet e pushtetit lokal (bashkia, komuna) caktojnë një person për kontrollin e zbatimit të kontratës (mbikëqyrës), i cili paguhet nga taksat e mbledhura për shërbimin e pastrimit.
Neni 143 i Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë ndër të tjera përcakton se:
- Kontrollon ecurinë e punimeve në kompaninë e pastrimit sipas grafikëve të miratuar nga Bashkia;
- Kontrollon zbatimin e kontratës së lidhur midis Bashkisë dhe kompanisë së pastrimit;
- Lajmëron me shkrim në mënyrë periodike sipërmarrësin dhe eprorin direkt për problemet që dalin gjatë kontrollit;

- Cakton pikat e vendosjes së kontenerëve dhe bën azhornimin e tyre në hartë;
- Bën kontroll të përditshëm sipas grafikëve të miratuar nga Kompania e Pastrimit të Qytetit;
- I paraqet eprorit direkt grafikun javor e mujor të largimit të mbeturinave sipas detyrave e objektivave;
- Kontrollon kryerjen e të gjitha proceseve të pastrimit, frekuencën e tyre dhe cilësinë e pastrimit, bazuar në Rregulloren Higjeno-Sanitare, ligjet, vendimet dhe urdhëresat në fuqi;
- Mban procesverbale ditore për punën e pakryer për çdo zë pune dhe bën vlerësimin e tyre në lekë sipas detyrimeve kontraktuese. Procesverbalit duhet të firmoset dhe nga administratori i kompanisë së pastrimit apo përfaqësuesi i autorizuar ligjërish prej tij;
- Raporton çdo ditë në orën 14.00, tek eprori direkt rezultatet e kontrollit dhe vlerën në lekë të punimeve;
- Shqyrton ankesat e banorëve, bën vlerësimin e tyre dhe në bashkëpunim me firmën, Njësinë administrative (rajonin) kryen zgjidhjen e tyre;
- Brenda datës 5 të çdo muaji dorëzon tek eprori direkt situacionin përfundimtar të muajit të kaluar. Së fundmi, neni 7 i kontratës nr. 4558, datë 31.10.2014 nënshkruar mes palëve për këtë shërbim ndër të tjera përcakton se:
- Mbikëqyrësi do të kontrollojë çdo ditë të gjithë zërat e shërbimit sipas volumeve të ofertës;
- Mbikëqyrësi në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve dhe zv. Kryetarin e Infrastrukturës hartojnë grafikun javor/mujor të shërbimit, i cili i dorëzohet kontraktorit 10 ditë përpara zbatimit në terren;
- Mbikëqyrësi i autoritetit kontraktor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të kontraktuesit kryen kontroll ditor të shërbimit sipas grafikëve të miratuar.....Në fund të çdo muaji do të konfirmojë punimet e kryera në situacionin e paraqitur nga kontraktuesi mbi bazën e akt kontrolleve për punët e kryera apo proces verbaleve të mbajtura për punët e pa kryera;
- Mbikëqyrësi mban proces-verbal dhe situacion ditor për masën e kryerjes së shërbimit, aplikon ndalesa, gjoha dhe llogarit masën e penaliteteve për shërbim të pa kryer;
- Ndjek realizimin e shërbimeve të përcaktuara në kontratë dhe gjykon për cilësinë e realizimit të tyre. Në çdo rast, kur gjykon se shërbimet nuk janë kryer me cilësi ka të drejtën të kërkojë fillimisht ribërjen e tyre brenda një afati prej 3 orësh dhe në rast mos zbatimi, të zbresë nga situacioni mujor vlerën e punimeve të pa kryera;
- Ka të drejtë në çdo kohë të kontrollojë inventarin e sipërfaqeve që mund të shtohen/pakësohen, inventarin e mjeteve dhe fuqinë punëtore në funksion të realizimit të kontratës. Në zbatim të kësaj pike, mjetet dhe fuqia punëtore e tij duhet të jenë të angazhuar vetëm në funksion të kësaj kontrate, pa lejuar lëvizjen e tyre brenda orarit të punës në shërbime të tjera si pasojë e kontratave të tjera që shoqëria mund të ketë në zbatim me subjekte të tjera;
- Ka të drejtë të propozojë ndryshime të sipërfaqeve objekt i kësaj kontrate, në rastet kur ka shtesa të tyre si pasojë e kryerjes së investimeve në qytet. Këto ndryshime mund të bëhen pa shtuar apo pakësuar volumin total të ofertës për çdo zë;
- Situacionet mujore hartohen nga supervizori i BV në bashkëpunim me Drejtuesin teknik të shërbimit të pastrimit sipas proces verbalit ditor të hartuar nga të dyja palët;
Për sa më lart, Bashkia Vlorë ka caktuar një punonjëse në rolin e mbikëqyrëses së zbatimit të kontratës (në vijim mbikëqyrësi), e cila është në varësi të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve. Ky person i vetëm ka për detyrë të kontrollojë dhe konfirmojë çdo ditë realizimin e shërbimit të pastrimit për një volum prej 140 ton mbetje në të gjitha pikat e grumbullimit dhe verifikimin e fshirjes së një sipërfaqe prej 810.000 m² rrugësh, dhe larjen dhe lagjen e një sipërfaqe prej 350.000 m² rrugësh. Nga intervistimi me mbikëqyrësin e kontratës, rezultoi se procesi i mbikëqyrjes realizohej në mëngjes herët rreth orës 06:00-10:00 dhe jo në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit. Vetë grupi i auditimit, doli në terren në ditë të ndryshme për të kryer itinerarin e procesit të mbikëqyrjes për zërat e kontratës, nga ku rezultoi se intervali prej 4 orësh ishte i pamjaftueshëm për mbulimin total të të gjitha zonave qytetit. Përmendim këtu

edhe faktin se për secilin prej zërave të pastrimit në kontratë, operatorit ekonomik privat i parashikohet një interval kohor për realizimin e shërbimit përgjithësisht 6-8 orë, ku pjesa më e madhe e shërbimit kryhet me automjete. Theksojmë se për këtë proces janë përdorur listat e rrugëve që lahen dhe lagen të miratuara në datë 15.03.2019, pasi edhe pas disa kërkesave të grupit të auditimit, Bashkia Vlorë deri në këtë moment nuk vuri në dispozicion të gjitha grafikët dhe listat e rrugëve që lagen, lahen dhe fshihen të miratuara çdo vit, siç specifikohet në kontratë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se puna e mbikëqyrësit të kontratës është e dokumentuar vetëm nëpërmjet disa akt kontrolleve të thjeshta ditore ku konfirmohet realizimi i punëve të parashikuara sipas volumeve dhe jo nëpërmjet indikatorëve të qartë të përcaktuar në sistemet e kontrollit. Nga auditimi i të dhënave, grupi i auditimit gjykon se këto akt kontrolle janë tepër formale dhe nuk paraqesin gjendjen reale të kryerjes së shërbimit me argumentet si më poshtë:

- Siç është përmendur dhe në pyetjet më lart, Bashkia Vlorë nuk disponon një peshore për matjen e volumeve të mbetjeve të grumbulluara, ndërkohë që në akt kontrolle deklarohet se mblidhen përditë rregullisht 140 ton mbetje; Kjo shifër nuk mund të jetë kaq absolutisht fikse ndërkohë që gjatë sezonit të dimrit qyteti i Vlorës ka pothuaj gjysmën e fluksit të banorëve dhe vizitorëve që ka gjatë sezonit të verës;
- Në këto akt kontrolle deklarohet se larja dhe fshirja e rrugëve është realizuar me cilësi të mirë, ndërkohë që nga intervistimi me mbikëqyrësin dhe shqyrtimi i kontratës nuk identifikohen në asnjë rast indikator matës të cilësisë së pastrimit, pra me çfarë treguesish mbikëqyrësi del në përfundimin se cilësia është e mirë, e keqe, apo mesatare. Gjatë auditimit u konstatuan akt kontrolle në të cilat cilësia e fshirjes nuk ishte e mirë dhe ishte kërkuar ri-fshirja e këtyre rrugëve, por pa specifikuar se çfarë ishte konstatuar në këto rrugë, pra mbi çfarë treguesish ishte arritur në vlerësimin “jo e mirë”;
- Po kështu, në akt kontrolle deklarohet se larja e rrugëve ishte kryer me sasinë e duhur të ujit, ndërkohë që po njësoj, nuk evidentohet se me çfarë indikatorësh është matur “sasia e duhur” dhe mbi të gjitha ndërkohë që procesi i mbikëqyrjes nuk kryhet në kohë reale, nuk mund të konfirmohet sasia e ujit të përdorur nga OE. Për këtë rast përmendim edhe faktin se OE nuk e shoqëron dokumentacionin e mbajtur ditor p.sh. me proces-verbale për sasinë e mbushjes së autoboteve me ujë për secilin proces.

Referuar nenit 143 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Vlorë, standardet për cilësinë e pastrimit përcaktohen në Rregulloren higjieno-sanitare, por Bashkia Vlorë nuk ka hartuar një të tillë. Po kështu, detyrimi i vlerësimit të punëve të kryera sipas cilësisë përcaktohet edhe në nenin 7 të kontratës, megjithatë edhe në kontratë nuk janë përfshirë indikator për matjen e kësaj cilësie.

Në vijim të auditimit mbi procesin e mbikëqyrjes së kontratës, u vu re se ka një mungesë komunikimi nga ana e mbikëqyrësit drejt eprorit direkt dhe njëkohësisht dhe një mungesë interesimi dhe kërkesë llogarie nga ky i fundit për procesin. Konkretisht, nuk u konstatua asnjë komunikim i dokumentuar mes mbikëqyrësit dhe Drejtorit të Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, qoftë lidhur me miratimin e grafikëve të punimit, me shkëmbim informacionesh mbi problematika që mund të lindin gjatë punës, mbi raportimet ditore brenda orarit të përcaktuar në rregullore, etj. Nuk u konstatua i dokumentuar asnjë adresim i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve qoftë në instanca më të larta brenda institucionit, ashtu edhe drejt OE që ofron shërbimin, mbi problematika të hasura vazhdimisht për çështjen e pastrimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, si p.sh. mungesa e vazhdueshme e ndërgjegjësimit të popullsisë për hedhjen e mbetjeve të pa pranueshme, neglizhenca e tyre për reduktimin e mbetjeve, problematika të mblidhjes së plastikave nga persona të pa autorizuar, etj. Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies, një shërbim kaq parësor dhe i kushtueshëm nuk mund të administrohet vetëm nga OE privat dhe mbikëqyrësi i kontratës.

Po kështu, lidhur me detyrimet e tjera të mbikëqyrësit konstatohet se nuk përmbushet detyrimi për kontrollin e mjeteve dhe fuqisë punëtore të angazhuar nëpërmjet kësaj kontrate. Duke qenë se procesi i mbikëqyrjes kryhet disa orë pas përfundimit të shërbimit dhe jo në kohë reale,

mbikëqyrësi nuk më të garantojë përmbushjen e përcaktimit të kontratës, sipas të cilit të gjithë mjetet dhe fuqia punëtore e kontraktuar duhet të jenë në dispozicion vetëm për këtë shërbim brenda orarit të caktuar dhe nuk lejohet angazhimi i tyre brenda këtij orari, në shërbime të tjera si pasojë e kontratave të tjera që OE mund të ketë. Gjithashtu, lidhur me disponueshmërinë e mjeteve, mbikëqyrësi duhet të kontrollojë edhe gjendjen teknike të mjeteve në funksion të kontratës, gatishmërinë e tyre për punë si dhe raste të dëmtimeve të ndryshme. Lidhur me këtë detyrim, nga përgjigjet e pyetësorëve rezulton se dëshmitë e vetme që pranohen për gjendjen e mjeteve janë kontrollet teknike të përvitshme që kryen çdo mjet në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që mbikëqyrësi kryen vizita në parkun e mjeteve dy herë në vit për të verifikuar prezencën dhe gatishmërinë e tyre, por ky proces nuk është i dokumentuar pasi mbikëqyrësi nuk vuri në dispozicion asnjë dokument verifikues për sa më lart. Mbikëqyrësi nuk kryen një proces rigoroz verifikimi të gjendjes teknike apo dokumentacionit që verifikon këtë aspekt të mjeteve, si dhe nuk administron në dosjen e tij dokumentacionin e duhur për çdo shërbim apo mirëmbajtje që i bëhet mjeteve. Mungesa e transparencës së këtij procesi mund të shoqërohet me kosto financiare, pasi referuar llogaritjes së fondit limit për këtë shërbim, Bashkia Vlorë paguan për çdo element të mirëmbajtjes së këtyre mjeteve si, vajra, pjesë këmbimi, goma, karburant etj. dhe për këtë arsye ka të drejtë të jetë e informuar mbi kostot dhe gjendjen e mjeteve ku po shpenzon. Kjo metodologji verifikimi do të shërbente edhe në përlllogaritjet e ardhshme të fondit limit për kontrata të ngjashme, duke sjellë një përlllogaritje më eficiente. Gjithashtu, lidhur me këtë element, neni 16 i kontratës parashikon se operatori duhet ti paraqesë AK raporte mujore dhe vjetore të cilat të përmbajnë listën dhe gjendjen aktuale të të gjithë automjeteve dhe pajisjeve që përdoren për proceset e punës sipas preventivit, një përmbledhje e rasteve të dëmtimeve, si dhe një përmbledhje e të gjitha situacioneve të dorëzuara deri në atë moment. Këto raporte duhet të dorëzohen brenda 15 ditëve nga fillimi i vitit të ri kontraktual dhe në rast të mos dorëzimit të tyre, Bashkia Vlorë ka të drejtë të mos kryej pagesën për muajin pasardhës. Nga auditimi u konstatua se, megjithëse operatori nuk vinte në dispozicion raporte të tilla, përsëri pagesat për shërbimin ishin kryer rregullisht.

Lidhur me hartimin e situacioneve mujore nga mbikëqyrësi në bashkëpunim me drejtuesin teknik të OE, të cilat konfirmohen po nga mbikëqyrësi, rezultoi se në situacionin e muajit mars 2019, pavarësisht se në akt kontrollet e periudhës 1-15 mars janë pasqyruar sipërfaqet dhe vlerat në lekë të punimeve të pa kryera për shkak të rikonstruksionit të bulevardit Skelë-Vlorë, akt kontrolle të firmosur nga të dy përfaqësuesit si BV ashtu dhe OE, përsëri situacioni përfundimtar mujor është hartuar në vlerën e plotë të punimeve. Për këtë rast, procesverbali i mbajtur më datë 15.03.2019 që specifikon sipërfaqet dhe vlerat në lekë të punimeve të pa kryera është mbajtur vetëm nga mbikëqyrësi i kontratës dhe jo së bashku me drejtuesin teknik të OE, siç parashikohet në nenin 7.5 të kontratës, çka dëshmon për një punë formale dhe jo të koordinuar mes dy përfaqësuesve.

Për sa më lart rezulton se mbikëqyrësi nuk kryen me rigorozitet procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës. Krahas pamundësisë fizike për të verifikuar në pak orë të gjitha volumet e punës të parashikuara, procesi i mbikëqyrjes është tepër formal dhe shpesh shumë elementë të kontratës anashkalohen. Po kështu, një pjesë e madhe e punës bëhet e pa dokumentuar.

Gjetje: Në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Bashkisë dhe përcaktimeve të kontratës së shërbimit nr. 4558, nr. 4558, datë 31.10.2014:

- ✓ Procesi i mbikëqyrjes realizohej në mëngjes herët rreth orës 06:00-10:00 dhe jo në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit;
- ✓ Puna e mbikëqyrësit të kontratës është e dokumentuar vetëm nëpërmjet disa akt kontrolleve të thjeshta ditore ku konfirmohet realizimi i punëve të parashikuara sipas volumeve;
- ✓ Nuk identifikohen në asnjë rast indikator matës të cilësisë së pastrimit, pra me çfarë treguesish mbikëqyrësi del në përfundimin se cilësia është e mirë, e keqe, apo mesatare;
- ✓ OE nuk e shoqëron dokumentacionin e mbajtur ditor me detaje mbi punët e kryera, p.sh. me proces-verbale për sasinë e mbushjes së autoboteve me ujë për secilin proces, me adresat se cilat

zona janë më problematike duke gjetur vazhdimisht hedhjen e mbetjeve të papranueshme jashtë kontenierëve, etj.;

- ✓ Nuk u konstatua asnjë komunikim i dokumentuar mes mbikëqyrësit dhe Drejtorit të Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, qoftë lidhur me miratimin e grafikëve të punimit, me shkëmbim informacionesh mbi problematika që mund të lindin gjatë punës, mbi raportimet ditore brenda orarit të përcaktuar në rregullore, etj.;
- ✓ Nuk u konstatua i dokumentuar asnjë adresim i Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve qoftë në instanca më të larta brenda institucionit, ashtu dhe drejt OE që ofron shërbimin, mbi problematika të hasura vazhdimisht për çështjen e pastrimit dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre, si p.sh. mungesa e vazhdueshme e ndërgjegjësimit të popullsisë për hedhjen e mbetjeve të pa pranueshme, neglizhenca e tyre për reduktimin e mbetjeve, problematika të mbledhjes së plastikave nga persona të pa autorizuar, etj.;
- ✓ Mbikëqyrësi nuk përmbush detyrimin për kontrollin e mjeteve dhe fuqisë punëtore të angazhuar nëpërmjet kësaj kontrate, si dhe nuk kryen një verifikim të detajuar të gjendjes teknike të mjeteve apo dokumentacionit që konfirmon këto elementë të mjeteve, apo shërbimet dhe mirëmbajtja që i bëhet atyre. Dëshmitë e vetme që pranohen për gjendjen e mjeteve janë kontrollet teknike të përvitshme që kryen çdo mjet në Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që mbikëqyrësi kryen vizita në parkun e mjeteve dy herë në vit për të verifikuar prezencën dhe gatishmërinë e tyre, por ky proces është i pa dokumentuar.

Konkluzione:

- ✓ Intervali prej 4 orësh i procesit të mbikëqyrjes së shërbimit dhe i kryer vetëm nga një person, është i pamjaftueshëm për mbulimin total të të gjitha zonave qytetit;
- ✓ Procesi i mbikëqyrjes së zbatimit të kontratës nuk kryhet me rigorozitet. Krahas pamundësisë fizike të mbikëqyrësit për të verifikuar në pak orë të gjitha volumet e punës të parashikuara, procesi i mbikëqyrjes është tepër formal dhe shpesh shumë elementë të kontratës anashkalohen;
- ✓ Mungesa e transparencës lidhur me verifikimin e gjendjes së mjeteve mund të shoqërohet me kosto financiare, pasi referuar llogaritjes së fondit limit për këtë shërbim, Bashkia Vlorë paguan për çdo element të mirëmbajtjes së këtyre mjeteve si, vajra, pjesë këmbimi, goma, karburant etj dhe për këtë arsye ka të drejtë të jetë e informuar mbi kostot dhe gjendjen e mjeteve ku po shpenzon;
- ✓ Një pjesë e madhe e punës është e pa dokumentuar, duke rezultuar në mungesë transparence në vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve.

Rekomandime:

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve në bashkëpunim me mbikëqyrësin e kontratës, të marrin masa për menaxhimin e kapaciteteve për të kryer një proces të plotë mbikëqyrës për të gjithë shërbimin e pastrimit dhe mbi të gjitha ky proces të kryhet në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit dhe jo në përfundim të tij.

Dhjetor 2021

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi të garantojnë realizimin e një inspektimi më serioz dhe mbajtjen e dokumentacionit të detajuar për punimet e kryera. Ky dokumentim të shoqërohet edhe me komunikime shkresore zyrtare me eprorë, operatorin ekonomik, apo dhe ankesa të qytetarëve. Në këtë kontekst, të kërkohet më tepër llogaridhënie në dokumentimin e procedurave që kryen operatori ekonomik për elementë të ndryshëm të ofrimit të shërbimit, si p.sh. procesverbale të sasisë së ujit që mbushen autobotet çdo ditë, faturime dhe dokumente të tjera justifikuese për çdo riparim, mirëmbajtje apo ndërhyrje të kryer në mjetet në dispozicion të kontratës, për të cilat paguan Bashkia, etj.

Tetor 2021

1.2.2 A janë zbatuar me përpikmëri detyrimet e kontratës sa i takon largimit të mbetjeve/fshirjes dhe larjes së rrugëve/edukimit publik?

Kontrata objekt i periudhës së auditimit është nënshkruar mes palëve më datë 31.10.2014 për një periudhë shërbimi 5 vjeçare, me një vlerë totale prej 927,406,605 lekë pa TVSh, ose 185,481,321 lekë/vit, me preventivin si vijon:

Shërbimi	Sasia	Çmimi/njësi	Çmimi total	Afati	Orari
Ngarkim/transport mbeturina	381.425 kontenier/vit 51.100 ton/vit	242.43 lekë/kont 1809.588 lekë/ton	92,469,955 lekë	12 muaj	22:00-06:00
Fshirje e rrugëve dhe shesheve	252.720.000 m ² /vit	0.26 lekë/m ²	65,841,832 lekë	12 muaj	22:00-06:00
Larje e rrugëve me ujë	105.000.000 m ² /vit	0.11 lekë/m ²	12,391,174 lekë	10 muaj	23:00-04:00
Lag'je e rrugëve me ujë	63.000.000 m ² /vit	0.07 lekë/m ²	5,004,505 lekë	6 muaj	06:00-08:00 15:00-18:00
Sistemim mbeturina	381.425 kont/vit	25.62 lekë/kont	9,773,855	12 muaj	-

Burimi: Preventivi i kontratës

Pavarësisht se afati i zbatimit të kësaj kontrate ka përfunduar në fund të vitit 2019, për këtë pyetje të piramidës, grupi i auditimit ka zhvilluar vizita në terren për të vlerësuar mënyrën e punës dhe nivelin e shërbimit të ofruar nga OE në funksion të pastrimit të qytetit. Kjo edhe për faktin se nga konsultimi me mbikëqyrësin e kontratës që në fillim të fazës së terrenit, u konfirmua se kontrata aktuale nuk ka ndryshime thelbësore nga kontrata e kaluar objekt auditimi, sa i takon planifikimit dhe metodologjisë së punës të këtij shërbimi. Rezultatet e vizitave në terren gjenden të faktuara me foto në anekset bashkëlidhur këtij raporti.

Referuar përcaktimeve të kontratës, kontraktuesi merr përsipër të realizojë të gjitha shërbimet e pastrimit në territorin e caktuar në volumet ditore sipas zërave si më poshtë:

- Ngarkim dhe transport mbeturinash për një volum prej 140 ton/ditë, shërbim i cili do të kryhet çdo ditë në orarin 22:00 – 06:00;
- Fshirje e rrugëve dhe shesheve në volumet 610.000 m² një herë/ditë dhe 100.000 m² dy herë/ditë, pra një total prej 810.000m²/ ditë, në oraret 22:00 – 06:00. Për këtë zë nuk është e përcaktuar se në cilin orar bëhet fshirja dy herë në ditë;
- Larje e rrugëve me ujë, që përfshin larjen me ujë me presion të rrugëve dhe shesheve në një sipërfaqe totale prej 350.000 m²/ditë, proces i cili do të kryhet në orarin 23:00 – 04:00;
- Lag'je e rrugëve për freskimin e qytetit dhe uljen e pluhurave për një sipërfaqe prej 175.000 m², shërbim i cili do të kryhet dy herë në ditë, në oraret 06:00 – 08:00 dhe 15:00 – 18:00;
- Sistemim mbeturina në fushën e depozitimit për 1045 kontenierë në ditë.

Lidhur me shërbimin e ngarkimit dhe largimit të mbetjeve nga pikat e depozitimit, OE ka për detyrë heqjen periodike të tyre nga të 1045 kontenierët e shpërndarë në qytet. Për këtë shërbim nuk ka grafikë pune, pasi mbledhja dhe largimi i mbetjeve bëhet rregullisht çdo ditë. Megjithatë, në kontratë parashikohet se me raste, pa pagesë shtesë, mund të kërkohen shkarkime edhe më të shpeshta në zonën bregdetare gjatë sezonit turistik. Për këto volume shtesë do të mbahet dokumentacioni përkatës nga mbikëqyrësi dhe ato do të kompensohen në muajt pasardhës. Ky fakt u pohua edhe verbalisht

nga mbikëqyrësi i kontratës, megjithatë i pa dokumentuar sipas pikave dhe sasive se ku janë kryer grumbullimet më tepër se njëherë në ditë dhe në cilat ditë dhe pika janë kompensuar këto vëllime në muajin pasardhës. Nga akt kontrollet e mbajtura nga OE rezulton se ky i fundit ka kryer gjatë muajit shkurt 2017 shërbimin e larjes së rrugëve çdo ditë me kërkesë të Bashkisë edhe pse ky shërbim nuk parashikohet në kontratë për muajt janar-shkurt, e megjithatë është deklaruar. Ndërkohë që për ndryshimet e volumeve në mbledhjen e mbeturinave gjatë sezonit turistik, nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Po kështu edhe në situacionet e vëna në dispozicion, deklarohet se OE mbledh rregullisht çdo ditë të vitit 140 ton mbetje. Gjatë të gjithë qëndrimit të grupit të auditimit në qytetin e Vlorës, u konstatua se në shumë pika grumbullimi, përgjithësisht në zonat e hoteleve (p.sh. Lungomare dhe rruga Aleksandër Moisiu) të cilat në periudhën e dimrit janë të shkreta, kontenierët ishin pothuaj të zbrazët, çka të lehtë kuptosh se në sezone jo të populluara nuk mund të mbledhet e njëjta sasi mbetjesh si në sezonet e mbipopulluara. Sa i takon përsëri kontenierëve, AK ka për detyrë përcaktimin e pikave të grumbullimit dhe numrin e kontenierëve për secilën pikë.

Referuar nenit 21.1.6 të kontratës, të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve duhet të identifikohen me një numër përkatës dhe lehtësisht të dukshëm për komunitetin. OE mund të vendosë këto numra në njërin prej kontenierëve ose në ambiente të tjera rreth pikës, elementë të cilët nuk u konstatuan në asnjë rast në disa prej pikave të grumbullimit që u vizituan. Po kështu, makinat teknologjike dhe kontenierët duhet të përmbajnë mbishkrime që specifikojnë llojin e mbeturinave që mbledhin dhe orarin e këtij shërbimi.

Referuar nenit 21.1.2 të kontratës, punëtorët e transportit kanë për detyrë të heqin të gjithë mbeturinat familjare nga pikat e grumbullimit, të bëjnë fshirjen me fshesë, si dhe dezinfektimin me gëlqere të vend grumbullimit me një reze prej 10 m². OE gjithashtu, ka për detyrë edhe grumbullimin dhe largimin e mbetjeve të pa pranueshme të cilat hidhen jashtë kontenierëve, të tilla si orendi shtëpiake, inerte, etj., të cilat depozitohen në pika të tjera grumbullimi dhe jo në fushën e depozitimit të mbetjeve. Për sa më lart, u konstatua se përgjithësisht dezinfektimi rigoroz kryhej vetëm në rrugët kryesore dhe më të frekuentuara të qytetit, ndërkohë që mes lagjesh u konstatuan pika ku dezinfektimi kryhej vetëm në një rrip të hollë toke poshtë kontenierëve dhe jo në sipërfaqen prej 10 m² dhe akoma më thellë në qytet, u konstatuan edhe zona kontenierësh të pa dezinfektuar fare. Po kështu, në shumë raste u konstatuan kontenierë të tej mbushur që në orare të hershme gjatë paradites dhe numri i tyre ishte i pa mjaftueshëm për të përballuar volumet deri në orët e natës kur fillon shërbimi i mbledhjes së tyre. Në përfundim të grumbullimit, kontenierët duhet të sistemohen drejtë, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban, si dhe me kapakë të mbyllur. Lidhur me këto përcaktime të kontratës, në shumë raste nuk u konstatua vendosja në pozicion vertikal e kontenierëve, kjo edhe për faktin se masivisht konstatoheshin persona të pa autorizuar të cilët i lëvizin këto kontenierë për të mbledhur plastikat, ndërkohë që asnjë nga kontenierët e vizituar nuk përmbajnë më kapakë.

Referuar nenit 13 dhe 21.1.6 të kontratës, kontenierët janë në pronësi të Bashkisë dhe OE ka përgjegjësi për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre, si dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit dhe mbajtjen pastër të tyre. Në raste dëmtimesh, djegiesh, deformimesh, apo dëmtime rrotash dhe kapakësh për çdo shkak, të cilët çojnë në mos funksionimin teknik, higjenik, apo estetik të kontenierëve, OE ka për detyrë riparimin e tyre brenda 15 ditësh nga konstatimi i tyre dhe në rast të mos përmbushjes së këtij detyrimi, autoriteti kontraktor do të mbajë vlerën e riparimit nga situacioni pasardhës. Për sa më lart, në shumë raste u konstatuan kontenierë të deformuar dhe pa rrota dhe siç u përmend më lart të gjithë pa kapakë, për të cilët nuk është marrë asnjë masë riparimi, pavarësisht se në përllogaritjen e çmimit të kontratës Bashkia Vlorë i paguan operatorit ekonomik 1,980,000 lekë/vit pjesë këmbimi (rrota) për kontenierët.

Referuar nenit 21.1.3, grafikët e operimit për shërbimin e pastrimit duhet të miratohen çdo vit dhe në to duhet të përcaktohen qartë oraret e operimit për secilën pikë kontenierësh; llojin, targën dhe itinerarin e makinave teknologjike në funksion të këtij zëri; oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse, si dhe numri i punëtorëve që do mbështesin çdo operacion punimesh. Për këto elementë të kontratës, AK ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë gjatë orarit të punës dhe deri

një orë pas përfundimit të shërbimit. Po kështu, referuar nenit 21.1.6, AK ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë gjendjen dhe gatishmërinë e mjeteve në funksion të kësaj kontrate. Këto mjete duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës dhe duhet të jenë të pastra në fillimin e shërbimit ditën pasardhëse në përputhej me përcaktimet e kërkesave higjieniko-shëndetësore parashikuar në nenin 10 të ligjit për largimin e mbetjeve. Për sa më lart gjatë auditimit u konstatua se, nuk ka transparencë në dokumentimin e punës së kryer për zërin ngarkim dhe transport mbetjesh, pasi mungojnë grafikët e hartuar dhe miratuar me vend ndodhjen e pikave të grumbullimit dhe numrin e kontenierëve për secilën pikë, oraret e prezencës së automjeteve mbledhëse në secilën pikë, targat e tyre, etj.

Nga inventarizimi i kontenierëve rezulton se për periudhën objekt auditimi Bashkia Vlorë ka nxjerrë jashtë përdorimi 320 kontenierë (200 në vitin 2018 dhe 120 në vitin 2019). Nga inventarët e mbajtur rezulton se gjatë kësaj periudhë nuk janë bërë hyrje të reja kontenierësh dhe është operuar përkatësisht me 1.092 kontenierë në vitin 2017 dhe 2018, me 892 kontenierë në vitin 2019 dhe me 772 kontenierë në vitin 2020 dhe jo me 1045 kontenierë çdo vit, siç deklarohet në situacione dhe akt kontrolle. Në akt kontrollet e mbajtura nga OE gjatë të gjithë vitit 2018 deklarohet se janë mbledhur 1050 kontenierë/ditë dhe jo 1.092 saç ka në inventar Bashkia, apo 1045 saç përcaktohet në kontratë. Po kështu, gjatë sezonit turistik korrik-gusht, në këto akt kontrolle deklarohet se janë mbledhur 1500 kontenierë/ditë, por në situacionet e muajve përkatës deklarohet gjithsesi një volum fiks prej 140 ton mbetjesh, i njëjtë me atë të mbledhur edhe nga 1050 kontenierë.

Nga diskutimet me mbikëqyrësin e kontratës u pohua se OE ka vënë në dispozicion të shërbimit të pastrimit 100 kontenierë vetëm në vitin 2015, pra për periudhën objekt auditimi nuk ka pasur kontenierë jo në pronësi të Bashkisë. Gjithashtu, për shkak të mos kryerjes së procesit të mbikëqyrjes në kohë reale nuk mund të faktohet nëse automjetet dhe kontenierët janë larë dhe dezinfektuar për të qenë të pastër në fillimin e ditës pasardhëse siç specifikohet në kontratë. Gjatë diskutimeve me mbikëqyrësin e kontratës u pohua se automjetet teknologjike lahen çdo ditë në pika lavazhesh. Megjithatë ky proces i tyre nuk është i dokumentuar dhe në çdo rast, kërkesat higjieniko-shëndetësore të cituara në nenin 10 të ligjit për largimin e mbetjeve, nuk mund të kufizohen vetëm me një larje në lavazh, për shkak të riskut të lartë të nivelit të ndotjes që mbartin në mjedisin ku operojnë.

Së fundmi, një situatë shqetësuese prej kohësh lidhur me ndotjen dhe depozitimin e mbetjeve përbën edhe zona e njohur si lagja 24 maji. Vetëm 2.6 km nga qendra e qytetit, kjo zonë është në një gjendje të mjerueshme ku prej vitesh depozitohen sasi të konsiderueshme mbetjesh në fusha shumë pranë banesave të qytetarëve. Gjatë auditimit në terren, u konstatua se përgjatë të gjithë rrugës Sokrat Leka, mbetjet janë të depozituara kudo përgjatë rrugës ndërkohë që e gjithë zona e kufizuar nga rrugët Andrea Varfi, Damian Humariti dhe Sokrat Leka¹² është në gjendje të mjerueshme sa i takon nivelit të pastërtisë. Në këtë zonë, përveç se rrugët e përmendura nuk janë pjesë e listës së rrugëve që lahen dhe fshihen edhe pse në parametra janë të asfaltuara, kanë sipërfaqe të konsiderueshme dhe janë të frekuentueshme, problematike shfaqet edhe situata me depozitimin e mbetjeve kudo.

Lidhur me shërbimin e fshirjes, operatori ka për detyrë fshirjen dhe kryerjen e shërbimeve të tjera mbështetëse për të gjitha rrugët dhe sheshet e kategorisë së parë e të dytë për një sipërfaqe të përgjithshme prej 810.000 m²/ditë, nga të cilat 180.000 m² janë parashikuar të fshihen me autofshesa, kurse 630.000 m² ku bëjnë pjesë trotualet e rrugëve të kategorisë së parë, si dhe rrugët e kategorisë së tretë e të katërt, do të fshihen me fshesa. Po kështu, duhet të bëhet gërryerja e kunetave dhe e mbetjeve prej balte. Në rast të pamundësisë së fshirjes me autofshesë për shkak të parkimeve në anë të rrugës, apo shkaqe të tjera objektive, OE është i detyruar ta kryej këtë proces me metoda të tjera alternative që i gjykon të nevojshme. Në këtë rast, operatori duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për realizimin e procesit me metoda alternative jo më vonë se 3 orë nga përfundimi i shërbimit. Në rast të kundërt, përgjegjësia është e operatorit dhe do të penalizohet sipas legjislacionit në fuqi.

¹² Kufizimi i zonës është bazuar në hartën online

Grafikët e shërbimit për këtë qëllim përgatiten dhe miratohen nga sipërmarrësi çdo vit dhe mund të pësojnë ndryshime në oraret e operimit vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimeve në anët e rrugëve. Këto grafikë duhet të përmbajnë listën e rrugëve që fshihen me autofshesa dhe ato me fshesa, orarin e operimit në secilën rrugë dhe numrin e punëtorëve që do punojnë në çdo operacion shërbimi. Gjatë procesit të fshirjes ndalohej kategorikisht hedhja e mbetjeve në pusetat e elektrikut, telefonisë, ujësjellësit etj. Të gjitha makineritë dhe pajisjet që do përdoren për shërbimin e fshirjes, duhet të lahen dhe pastrohen në fund ose në fillim të shërbimit ditor dhe do të kontrollohen nga AK për gjendjen, inventarin dhe gatishmërinë e tyre jo më vonë se 6 muaj. Po kështu, duhet të sigurohet që edhe qendra e grumbullimit të punëtorëve të jetë në përputhje me kushtet higjieno sanitare.

Për këto elementë të shërbimit të fshirjes, nga auditimi u konstatua se, grafikët e punës nuk miratohen çdo vit dhe ato nuk përmbajnë detajet e parashikuara në kontratë, si rrugët që fshihen me autofshesë dhe ato me fshesë, oraret e operimit në secilën rrugë dhe numrin e punëtorëve që do të veprojnë në çdo rrugë. Nga vizitat në terren u konstatua se në pjesën më të madhe të rrugëve ato janë të zëna nga parkimet e makinave nga njëri krah dhe në më pak raste në të dyja krahet. Në rrugët e zëna nga parkimet u konstatua prani e madhe pluhuri dhe nuk ishte kryer gërryerja e kunetave apo e baltës. Për këto raste, në pamundësi të kalimit të autofshesave, mund të dalloheshin gjurmët e fshirjes së kunetave me fshesë, megjithatë pluhuri ishte ende prezent. Ndër rrugët që mund të fshiheshin me autofshesa lirisht dhe ku dallohej cilësia më e mirë e procesit ishin rrugët që nuk kanë prani parkimesh si Lungomare dhe Bulevardi Vlorë-Skelë. Po kështu, në pak raste u konstatua edhe hedhja e mbeturinave të mbledhura (në pjesën më të madhe gjethet e rëna) në brendësi të pusetave të ujësjellësit apo elektrikut. Theksojmë për këtë rast se vizitat në terren janë kryer bazuar në listën e vetme të miratuar të rrugëve që u vu në dispozicion të grupit të auditimit e cila daton më 15.03.2019, pasi gjatë të gjithë procesit të auditimit, nuk janë vënë në dispozicion grafikët e miratuar të punimeve.

Nga shqyrtimi i kësaj liste, u vu re se jo i gjithë qyteti dhe rrugët mbuloreshin me shërbim sa i takon procesit të fshirjes. Në disa raste u konstatua se kishte rrugë që nuk ishin të përfshira në listën e rrugëve që lahen dhe fshihen edhe pse të njëjtës tipologji, sipërfaqe etj. me rrugët e miratuara për këtë shërbim. Rrugët si Dervish Hekali, Jeronim de Rada, Dëshmorët, etj. nuk ishin pjesë e listës së rrugëve që pastrohen edhe pse ishin vijim i rrugëve të përfshira tashmë në listë.

Një tjetër element i konstatuar gjatë auditimit lidhet me orarin e operimit për procesin e fshirjes. Referuar përcaktimeve të kontratës, procesi i fshirjes do të kryhet gjatë natës në orarin 22:00-06:00, ndërsa procesi i larjes do të kryhet në orarin 23:00-04:00, nga ku rezulton se procesi i fshirjes vijon edhe 2 orë pas përfundimit të afatit për larje, në një kohë kur procesi i larjes duhet të fillojë pas përfundimit të procesit të fshirjes në mënyrë që të jetë eliminuar pluhuri prezent në rrugë.

Së fundmi, ashtu si u trajtua edhe në rastin e automjeteve dhe pajisjeve për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve edhe në rastin e mjeteve dhe të pajisjeve për procesin e fshirjes nuk rezultoi e dokumentuar asnjë nga përcaktimet e kontratës lidhur me larjen dhe pastrimin e tyre, me kushtet higjieno-sanitare të pikës së grumbullimit të punëtorëve dhe as me kontrollin për inventarin dhe gjendjen e këtyre mjeteve dhe pajisjeve çdo 6 muaj.

Lidhur me procesin e larjes dhe lagjes, operatori ka për detyrë larjen me ujë me presion të rrugëve që kanë kunetë të rregullt për shkarkimin e ujërave për një periudhë 10 mujore (mars-dhjetor), si dhe lagjen e tyre për të freskuar mjedisin dhe uljen e pluhurave dy herë gjatë ditës (06:00-08:00 dhe 15:00-18:00) për një periudhë 6 mujore (prill-shtator). Shërbimi i lagjes ofrohet vetëm për rrugët kryesore të qytetit. Edhe për këtë zë, grafikët e punës duhet të miratohen çdo vit dhe duhet të përmbajnë oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar, llojin dhe itinerarin e makinave teknologjike që do kryejnë shërbimin, si dhe numrin e punëtorëve që do punojnë në çdo operacion. Të gjitha shpenzimet për ujin që do të përdoret, përballohen nga operatori. Po kështu, duhet të sigurohet mbajtja pastër e mjeteve të punës për këtë shërbim, si dhe të kryhet kontrolli i gjendjes së tyre jo më vonë se 6 muaj.

Edhe për sa më lart, gjatë auditimit u konstatua se grafikët për këtë zë nuk miratohen çdo vit dhe nuk përmbajnë specifikimet e nevojshme. Për shkak të mungesës së përcaktimit të saktë të

orareve të larjes dhe lag'jes të secilës rrugë, nuk është e qartë se si alternohen këto dy procese, pasi vihet re se në përcaktimet e kontratës procesi i larjes përfundon në orën 04:00 dhe menjëherë në orën 06:00 fillon procesi i lag'jes. Kjo mungesë përcaktimesh në oraret e operimit në secilën rrugë sjell mungesë efieçience në ofrimin e shërbimit pasi intervali prej dy orësh nga procesi i larjes tek ai i lag'jes është shumë i shkurtër dhe nuk është e nevojshme lag'ja e rrugëve menjëherë pas larjes së tyre. Po kështu procesi i lag'jes i orës 06:00-08:00 përveç se shumë pranë procesit të larjes, kryhet dhe në një orar në të cilin nuk ka trafik mjetesh.

Duke pasur parasysh se qëllimi i këtij procesi është freskimi i ambientit dhe ulja e pluhurave, do të ishte më e nevojshme që ky proces të shtyhej për një orar gjatë ditës kur lëvizja është më e konsiderueshme dhe prania e pluhurit në ajër është më e lartë. Po kështu, rezulton se procesi i larjes dhe lag'jes nuk janë planifikuar në çdo ditë të vitit, me arsyetimin e llogaritjes të një numri mesatar ditësh me shi gjatë vitit në të cilat nuk mund të kryhet ky proces, si dhe sipas nevojës për freskimin e ambientit dhe eliminimin e pluhurave. Konkretisht, është llogaritur që procesi i larjes të mos kryhet në muajt janar-shkurt, ndërsa procesi i lag'jes të mos kryhet në muajt janar-mars dhe tetor-dhjetor. Megjithatë, nga shqyrtimi i akt kontrolleve, u konstatua se për vitin 2017, BV ka vlerësuar të nevojshme dhe ka kërkuar shërbimin e lag'jes së rrugëve edhe në muajt janar-shkurt, jashtë përcaktimit të kontratës. Në opinionin e grupit të auditimit, ndërprerja e shërbimit të larjes dhe lag'jes në periudha fikse 2 dhe 3 mujore nuk është një planifikim efektiv për pastrimin e qytetit. Për të pasqyruar mundësinë e ditëve me shi, BV mund të përcaktojë ditë të ndryshme gjatë muajve ku nga studimet prej vitesh rezulton se vendi ynë ka mot me shi dhe jo të ndërprerë për 2 muaj radhazi shërbimin.

Së fundmi, lidhur me sipërfaqet objekt shërbimi të kësaj kontrate, përcaktohet se mbikëqyrësi ka të drejtë të propozojë ndryshime të këtyre sipërfaqeve, në rastet kur ka shtesa të tyre si pasojë e kryerjes së investimeve në qytet. Këto ndryshime mund të bëhen pa shtuar apo pakësuar volumin total të ofertës për çdo zë. Për këtë rast, konstatohet se ky përcaktim nuk është i mirë menduar pasi për të shtuar një sipërfaqe nga një investim i ri, pa ndryshuar volumet totale të parashikuara në kontratë, do të thotë se duhet të hiqet e njëjta sipërfaqe nga një zonë tjetër, gjë që nuk sjell efektivitet në pastrimin e qytetit.

Ndër të tjera, referuar nenit 11 të kontratës së shërbimit, kontraktuesi ka detyrimin të zhvillojë një program të edukimit publik të destinuar për të përmirësuar njohuritë e konsumatorëve dhe banorëve të qytetit të Vlorës, për të rritur në maksimum pjesëmarrjen në programin e menaxhimit të mbeturinave, duke venë një theks të veçantë në grumbullimin e tyre në kontenierë, fshirjen e rrugëve, transportin e mbeturinave voluminoze, rrugët tregtare dhe respektimin e orareve përkatëse. Kontraktuesi do të kryej një herë në 6 muaj programin e edukimit ambiental i cili do të përbëhet nga prodhimi dhe transmetimi i një spoti televiziv sipas idesë dhe përmbajtjes së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Gjithashtu, kontraktuesi është i detyruar që një herë në 6 muaj të prodhojë dhe shpërndaj materiale informative të shkruara, broshura ose fletë palosje sipas idesë dhe përcaktimeve të AK.

Lidhur me këtë detyrim të kontratës, u konstatua se në llogaritjen e fondit limit nuk ka asnjë përllogaritje për zërin "Edukimi publik" dhe as në kontratë, në preventivin përkatës nuk parashikohen fonde për zhvillimin e programeve të edukimit, spoteve televizive, apo fletë palosjeve dhe broshurave informuese. Gjatë auditimit u vunë në dispozicion 3 modele posterash/broshurash me përmbajtje bazike, të cilët përgjithësisht bënin thirrje për mbajtjen pastër të qytetit por nuk përmbajnë informacione në ndihmë të qytetarëve se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penalitetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj.

Po kështu, nuk ka një përcaktim se në çfarë mënyre mbikëqyrësi do të monitorojë përmbushjen e këtij detyrimi dhe në asnjë rast nuk është kryer një vlerësim se në çfarë mase është realizuar ndërgjegjësimi i qytetarëve, apo fakti nëse ka pasur progres apo regres sa i takon kësaj çështje. Gjatë intervistimeve me mbikëqyrësin, rezulton se politikat/programet që lidhen me shërbimin e pastrimit nuk janë të orientuara drejt kënaqësisë së qytetarëve. Bashkia Vlorë nuk

ndërmerr zhvillimin e sondazheve apo pyetësorëve lidhur me kënaqësinë e qytetarëve mbi nivelin e pastrimit, apo mbulimin e zonave të tyre të banimit nga ky shërbim. Po kështu, në përgjigjet e pyetësorëve theksohet se shqetësues mbetet prej kohësh fakti i hedhjes së mbetjeve të pa pranueshme jashtë kontenierëve, çka do të thotë se kontraktuesi ka dështuar në përmbushjen e detyrimit për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Ky fakt vjen edhe si pasojë e neglizhencës së Bashkisë Vlorë në penalizimin e shkelësve të këtyre rregullave, si dhe të mbledhësve të pa autorizuar të plastikës.

Gjatë intervistimit u pohua se penalizimet për këto shkelje janë detyrë e policisë bashkiake, e cila vazhdimisht ka këshilluar vetëm gojarisht shkelësit, por nuk ka marrë masa të mëtijshme që parashikohen me ligj, pavarësisht se ky fenomen vazhdon rregullisht. Penalizimet me anë të gjobave janë të rralla dhe përgjithësisht për rastet e ndotjeve madhore, si p.sh. derdhjet e naftës. Në aktin kontrollit e mbajtura nga palët, vihet re se rregullisht çdo ditë deklarohet për mbledhje të mbetjeve të pa pranueshme të hedhura jashtë kontenierëve. Ky fenomen u vu re në shumë raste edhe nga vizitat e grupit të auditimit në terren¹³, e megjithatë si mbikëqyrësi, ashtu edhe OE të cilët referuar nenit 14.1 të kontratës kanë detyrimin të kallëzojnë pranë organeve kompetente për ndjekjen ligjore të shkaktarit, nuk kanë ndërmarrë asnjë iniciativë të tillë. Për shkak të nivelit të papërfillshëm të ndërgjegjësimin, përsëri edhe për 5-vjeçarin e ardhshëm, Bashkia ka parashikuar të njëjtën sasi të mbetjeve të pa pranueshme, pra 1/3 e vëllimit të përgjithshëm të mbetjeve.

Gjetje:

- ✓ Mbi procesin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, dezinfektimit të zonës dhe gjendjes së kontenierëve:
 - Bashkia Vlorë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor nuk ka operuar me grafikë për shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve, duke mos pasqyruar oraret dhe mjetet përkatëse për mbledhjen e tyre në secilën pikë;
 - Në aktin kontrollit e mbajtura nuk pasqyrohen rastet e mbledhjes së mbetjeve edhe gjatë ditës sipas nevojave (krahas detyrimit për mbledhjen gjatë natës);
 - Në shumë raste dhe të përsëritura, kontenierët ishin të tej mbushur që në orët e para të paradites;
 - AK nuk ka kryer identifikimin e kontenierëve dhe pikave të grumbullimit me një numër përkatës dhe lehtësisht të dukshëm për komunitetin, si dhe oraret e shërbimit;
 - Në disa raste kontenierët ishin të deformuar, pa rrota dhe në të gjitha rastet pa kapakë;
 - Mungon dokumentimi për procesin e larjes dhe pastrimit të automjeteve dhe mjeteve të punës, si dhe raportimet për gjendjen e tyre;
 - Gjatë periudhës objekt auditimi, mbledhja e mbeturinave është kryer jo me numrin e deklaruar prej 1045 kontenierë, por në disa raste më tepër se ky numër dhe në disa raste më pak;
 - Në lagje apo rrugë jo kryesore dezinfektimi nuk kryhej në rezen prej 10m² ose nuk kryhej fare;
 - Përgjatë rrugëve të lagjes 24 maji u konstatuan mbetje të depozituara kudo përgjatë rrugës;
- ✓ Mbi procesin e larjes dhe fshirjes së rrugëve e trotuareve:
 - Grafikët e punës për shërbimin e fshirjes nuk miratohen çdo vit dhe nuk përmbajnë detajet e parashikuara në kontratë si rrugët që fshihen me autofshesë dhe ato me fshesë, oraret e operimit në secilën rrugë dhe numrin e punëtorëve që do të veprojnë në çdo rrugë;
 - Në pjesën më të madhe të rrugëve ato janë të zëna nga parkimet e makinave nga njëri krah dhe në më pak raste në të dyja krahët. Në rrugët e zëna nga parkimet u konstatua prani e madhe pluhuri dhe nuk ishte kryer gërryerja e kunetave apo e baltës;
 - Rrugë të tilla si Sokrat Leka, Damian Humariti, Hajredin Danushi, Osman Haxhiu, Andrea Varfi, Dervish Hekali, Jeronim de Rada apo Dëshmorët nuk ishin të përfshira në listën e

¹³ Fotot bashkëlidhur anekseve

- rrugëve që lahen dhe fshihen edhe pse të të njëjtës tipologji, sipërfaqe etj. me rrugët e miratuara për këtë shërbim;
- Referuar afateve të kryerjes së shërbimeve, konstatohet se procesi i fshirjes së pluhurave vijon edhe 2 orë pas përfundimit të afatit për larjen;
 - Në asnjë rast nuk dokumentohet asnjë nga përcaktimet e kontratës lidhur me larjen dhe pastrimin e mjeteve dhe automjeteve të punës, me kushtet hijeno-sanitare të pikës së grumbullimit të punëtorëve dhe as me kontrollin për inventarin dhe gjendjen e këtyre mjeteve dhe pajisjeve çdo 6 muaj;
 - Në përcaktimet e kontratës procesi i larjes përfundon në orën 04:00 dhe menjëherë në orën 06:00 fillon procesi i lag'jes, pa përcaktuar në grafikë se çfarë intervali i takon çdo rrugë nga njëri proces në tjetrin;
 - Procesi i lag'jes i orës 06:00-08:00 përveç se shumë pranë procesit të larjes, kryhet dhe në një orar në të cilin nuk ka trafik mjetesh;
 - Për të pasqyruar mundësinë e motit me shi, Bashkia Vlorë nuk kryen larjen e rrugëve për dy muaj radhazi (janar-shkurt), dhe lag'jen e tyre për 3 muaj radhazi në dy intervale (janar-mars dhe tetor-dhjetor). Për këtë rast, në vitin 2017 Bashkia Vlorë ka kërkuar shërbim shtesë për larjen e rrugëve në muajt janar-shkurt kur nuk janë parashikuar në kontratë;
 - Mbikëqyrësi ka të drejtë të propozojë ndryshime të sipërfaqeve të rrugëve ku operohet, në rastet kur ka shtesa të tyre si pasojë e kryerjes së investimeve në qytet, por pa ndryshuar volumet totale të sipërfaqeve të përcaktuara në kontratë;
- ✓ Mbi nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve:
- Në llogaritjen e fondit limit dhe as në kontratë nuk ka asnjë përllogaritje për zërin “Edukimi publik”, i përcaktuar në kontratë për zhvillimin e programeve të edukimit, spoteve televizive, apo fletë palosjeve dhe broshurave informuese;
 - Në 3 modelet e posterave/broshurave të hartuara për edukimin publik përgjithësisht bëhet thirrje për mbajtjen pastër të qytetit por nuk ofrohet informacion në ndihmë të qytetarëve se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penalitetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj.;
 - Nuk ka një përcaktim se në çfarë mënyre dhe mbi vlerësimin e cilëve elementë mbikëqyrësi do të monitorojë përmbushjen e detyrimit mbi edukimin publik e ambiental;
 - Bashkia Vlorë nuk ndërmerr zhvillimin e sondazheve apo pyetësorëve lidhur me kënaqësinë e qytetarëve mbi nivelin e pastrimit, apo mbulimin e zonave të tyre të banimit nga ky shërbim;
 - Në aktin kontrollit e mbajtura nga palët, vihet re se rregullisht çdo ditë deklarohet për mbledhje të mbetjeve të pa pranueshme të hedhura jashtë kontenierëve. Penalizimet me anë të gjobave janë të rralla dhe përgjithësisht për rastet e ndotjeve madhore, si p.sh. derdhjet e naftës. Mbikëqyrësi dhe Operatori Ekonomik nuk kanë marrë asnjë masë për penalizimin e ndotësve edhe pse e kanë të parashikuar këtë detyrim në kontratë, por janë mjaftuar me këshillimin verbal të tyre.

Konkluzione:

- ✓ Mbi procesin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, dezinfektimit të zonës dhe gjendjes së kontenierëve:
- Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve kryhet me korrektësi, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për procesin e dezinfektimit të zonës përreth apo larjes dhe dezinfektimit të kontenierëve dhe mjeteve teknologjike;
 - Grupi i punës për hartimin e grafikëve dhe përcaktimin e pikave të vendosjes së kontenierëve nuk ka kryer një planifikim të saktë për shpërndarjen e tyre, duke qenë se në shumë raste kontenierët ishin të tej mbushur që në orët e para të paradites;

- Si pasojë e mungesës së peshores, dokumentacioni i mbajtur nga mbikëqyrësi dhe operatori ekonomik për zbatimin e kontratës plotësohet formalisht dhe nuk pasqyrohen saktë në këto dokumente volumet reale të mbetjeve të mbledhura çdo ditë;
- Përcaktimet e kontratës lidhur me riparimin apo mirëmbajtjen e kontenierëve nuk janë përmbushur dhe po kështu nuk është përmbushur as detyrimi i mbajtjes së vlerave të riparimeve nga situacionet pasardhëse;
- Hartimi i akt kontrolleve për shërbimin e pastrimit është tepër formal dhe nuk pasqyron informacionin e nevojshëm dhe të saktë mbi çdo proces;
- ✓ Mbi procesin e larjes dhe fshirjes së rrugëve e trotuareve:
 - Procesi i larjes dhe fshirjes nuk është i mirë planifikuar sa i takon orareve të operimit për secilin shërbim, apo alternimit të ditëve dhe këtyre orareve sipas nevojës, lidhur me rastet e motit me shi apo radhën e kryerjes së proceseve;
 - Gjatë planifikimit të shërbimit, Bashkia Vlorë nuk ka marrë në shqyrtim zgjidhje e problemit të pranisë së mjeteve të parkuara gjatë procesit të larjes dhe fshirjes së rrugëve, duke i lënë kunetat dhe pjesët anësore të rrugëve me pluhur dhe baltë;
 - Pavarësisht shifrës së lartë të shpenzuar për pastrimin e qytetit, jo i gjithë qyteti i Vlorës mbulohet me shërbim sa i takon procesit të fshirjes dhe larjes;
- ✓ Mbi nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve:
 - Modelet e fletë/palosjes/brosurave të shtypura dhe shpërndara nga Operatori Ekonomik nuk përmbajnë informacion apo elementë ndërgjegjësues sa i takon edukimit publik;
 - Si pasojë e konstatimit të vazhdueshëm të hedhjes së mbetjeve të pa përshtatshme jashtë kontenierëve, operatori ekonomik ka dështuar në përmbushjen e detyrimit për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe nxitjen e tyre për depozitimin e mbetjeve në kontenierët përkatës. Në këtë kontekst edhe Bashkia Vlorë ka qenë neglizhente në penalizimin e shkelësve të këtyre rregullave, si dhe të mbledhësve të pa autorizuar të plastikës;
- ✓ Kontrata e lidhur mes palëve nuk është zbatuar me rigorozitet pasi ka shumë elementë të përcaktuar në të, të cilët janë neglizhuar dhe gjithashtu ka mungesë transparence në garantimin e përmbushjes së çdo zëri të kontratës.

Rekomandime:

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për sigurimin e objekteve të caktuara për matjen e sasisë së mbetjeve, në mënyrë që të kryhet identifikimi i saktë i volumeve të mbetjeve që gjenerohen çdo ditë dhe dokumentimi i tyre të bëhet sipas sasive specifike dhe jo në formatin fiks prej 140 ton/ditë. Ky element do të ndihmonte edhe në procesin e planifikimit të volumeve dhe kostove në të ardhmen.

Në vijimësi

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa për studimin e zonave të cilat vazhdimisht kanë kontenierë të tej mbushur dhe zonave ku kontenierët qëndrojnë edhe të zbrazur dhe mbi këtë bazë të bëjë një riplanifikim dhe rishpërndarje të kontenierëve për çdo pike sipas nevojës.

Dhjetor 2021

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve të marrë masa dhe të kërkojë që Operatori Ekonomik përgjegjës për ofrimin e shërbimit të pastrimit, të përmbushë përcaktimet e nenit 21.1.6 sa i takon riparimit të të gjithë deformimeve apo zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të kontenierëve të dëmtuar dhe në të ardhmen, kjo drejtori të rrisë kërkesën e llogarisë ndaj detyrimeve që Operatori Ekonomik ka lidhur me mirëmbajtjen e kontenierëve.

Dhjetor 2021

- ✓ Bashkia Vlorë dhe Drejtoritë përkatëse brenda saj, të marrin masa për mundësinë e vendosjes së orareve të caktuara kufizuese gjatë natës për parkimin e mjeteve në anë të rrugës. Këto orare kufizimi për secilën rrugë të përputhen me oraret e kalimit të mjeteve pastruese në këto rrugë rast pas rasti sipas përcaktimeve në grafikë; për këtë qëllim, mbikëqyrësi i kontratës të marrë masa për hartimin e grafikëve me të gjitha detajet që parashikon kontrata për çdo zë, duke përfshirë orën e kalimit në secilën rrugë, mjetet në dispozicion në çdo operacion, targat e tyre, si dhe numri i punëtorëve për secilin prej tyre.

Dhjetor 2021

- ✓ Duke pasur si qëllim parandalimin e ngritjes së pluhurit dhe eliminimin e tij, grupi i punës për hartimin e grafikëve për këtë shërbim, të marrë masa për shmangien e kryerjes së procesit të larjes dhe lagjes në një diferencë fare të vogël oraresh mes tyre. Për këtë qëllim të vlerësohet mundësia e një shpërndarje të koordinuar të orareve për të dy proceset (lagjes dhe larjes) sipas nevojës dhe në perioda gjatë ditës në të cilat frekuentimi dhe prania e pluhurit në ajër janë më të larta, si dhe të përcaktohen specifikisht në këto grafikë orari i larjes dhe lagjes së secilës rrugë.

Në çdo kontratë pas ardhëse

- ✓ Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve dhe mbikëqyrësi i kontratës të marrin masa për angazhimin efektiv dhe me përgjegjshmëri të të gjitha strukturave përgjegjëse në çështjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi pastrimin e qytetit. Për këtë qëllim, të merren masa për aplikimin e penalteteve të parashikuara në ligj për rastet e përsëritura të shkelësve të ligjit. Po kështu, të merren masa për realizimin e fushatave të ndërgjegjësimit me karakter informues mbi detyrimet e qytetarëve ndaj këtij shërbimi që bashkia ofron, apo të dhëna se në cilat pika duhen hedhur mbetjet e pa pranueshme, çfarë penaltetesh ka për ndotësit dhe shkelësit e këtyre rregullave, cilat janë dëmet konkrete që vijnë nga ndotja, etj., si dhe vendosjen e një numri jeshil ku qytetarët të kenë mundësi të paraqesin ankesat dhe denoncimet e tyre.

Tetor 2021

4. Trajtimi i observacioneve

Me shkresën nr. 11043/1, datë 11.01.2021 “Observacion për KLSH”, protokolluar në KLSH me nr.645/5, datë 15.01.2021, Bashkia Vlorë ka paraqitur komentet mbi gjetjet dhe konkluzionet e projekt-raportit të auditimit, të cilat trajtohen si më poshtë:

- **Për pyetjen 1.1.1** nuk ka kundërshtime për gjetjet dhe rekomandimet, por lidhur me përcaktimin e metodave dhe teknologjive për largimin e mbetjeve, apo hartimin e planeve vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, Bashkia Vlorë shprehet se është në proces të ndërtimit të Landfillit dhe në vijim do të angazhohet edhe në përmbushjen e rekomandimeve të lëna.
- **Për pyetjen 1.1.2** lidhur me realizimin e një analize kostoje në përputhje me burimet në dispozicion, Bashkia Vlorë shprehet se e ka realizuar një analizë të detajuar kostoje para procesit të tenderimit të shërbimit. Megjithatë në këtë koment nuk është e qartë nëse i referohen kontratave të lidhura në vijim pas periudhës nën auditim dhe gjithashtu, komenti nuk shoqërohet me dokumentacion përkatës faktues, pra analizën e koston. Theksojmë gjithashtu se nuk ka asnjë dokumentacion provues që kjo analizë është kryer brenda kapaciteteve financiare të institucionit, i cili ka qenë edhe thelbi i pyetjes së raportit.
- **Për pyetjen 1.2.1** lidhur me mënyrën dhe orarin e kryerjes së procesit të mbikëqyrjes, nuk është paraqitur asnjë fakt i ri mbi konstatimet e grupit të auditimit, por është deklaruar përsëri se mbikëqyrja kryhet në orarin 06.00-10.00, pra jo në kohë reale siç është trajtuar edhe nga grupi i auditimit në projekt raport dhe jo i plotë duke mbuluar të gjithë itinerarin e shërbimit. Lidhur me mungesën e manualeve apo standardeve për matjen e cilësisë së shërbimit, Bashkia Vlorë shprehet se gjatë trajnimeve të shumta të kryera nga ministritë apo projekte të ndryshme

mbi shërbimin e pastrimit, është kërkuar hartimi i dokumenteve të tilla, por deri tani nuk ka pasur të tillë. Lidhur me këtë koment, nxisim Bashkinë Vlorë që duke konsultuar edhe praktikantët e mira, ky institucion është në pozicionin për të qenë vetë iniciator për përpilimin e dokumenteve të tilla që ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve që ofron. Lidhur me pretendimin se mbikëqyrësi dhe Drejtuesi i Drejtorisë së Infrastrukturës kanë një bashkëpunim shumë të ngushtë sa i takon mbarëvajtjes së këtij shërbimi, ku pavarësisht mungesës së dokumentimit, për këtë qëllim stafi dhe Kryetari kanë krijuar një grup në Whatsapp, sqarojmë se komunikimet në rrjete elektronike të ndryshme nga ato të përcaktuara në ligje e rregullore, nuk konsiderohen zyrtare, për më tepër mungesa e dokumentimit të tyre sjell mangësi në transparencë dhe mund të lerë vend edhe për abuzime. Së fundmi, lidhur me komentin se secili prej 5 rajoneve të qytetit të Vlorës disponon dhe punon sipas grafikëve të rrugëve e shesheve që fshihen e lahen, sqarojmë se përveçse këto grafikë nuk u vunë në dispozicion gjatë auditimit edhe pse u kërkuan disa herë, përsëri edhe me paraqitjen e observacioneve nuk u soll asnjë fakt apo dokument për të provuar prezencën e këtyre grafikëve siç përcaktohet në kontratë.

- **Për pyetjen 1.2.2** lidhur me pretendimin se është caktuar një mesatare për sasinë e mbetjeve që largohen çdo ditë pavarësisht sasisë reale të mbetjeve që largohen, sqarojmë se përveçse kjo metodë është mungesë transparence, ajo gjithashtu pengon në mbledhjen e statistikave dhe parashikimet për të ardhmen. Ri përsërisim se në asnjë rast sasia e mbetjeve të gjeneruara nuk mund të jetë kaq absolutisht e pa ndryshueshme për 10 vite rradhazi. Lidhur me pretendimin se për largimin e mbetjeve nuk operohet me grafikë shërbimi pasi ky proces kryhet çdo ditë, sqarojmë se në kontratën e firmosur mes palëve është rënë dakord që procesi i mbledhjes së mbetjeve do të kryhet sipas një grafiku ku të përcaktohen llojet e mjeteve dhe targat përkatëse që do kryejnë mbledhjen dhe transportin, oraret përkatëse për secilën pikë grumbullimi, si dhe numrin e punëtorëve prezent në moment. Së fundmi, lidhur me komentin mbi zëvendësimin e kontenierëve në të ardhmen, ky fakt do të verifikohet gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve në përfundim të afatit 6 mujor.

5. Përmbledhja

Për shërbimin e pastrimit vetëm brenda qytetit të Vlorës, pas përfundimit të procedurave të prokurimit, Bashkia Vlorë ka lidhur kontratën me nr. 4558, datë 31.10.2014, në të cilën përcaktohet se operatori ekonomik angazhohet të kryej shërbimin e pastrimit brenda qytetit për një periudhë 5-vjeçare, në vlerën totale prej 1,112,887,926 lekë me TVSh, ose 222,577,585 lekë/vit. Për të dalë në një përfundim mbi efektivitetin e shërbimit të pastrimit në qytetin e Vlorës, janë marrë në vlerësim dy komponentë të rëndësishëm të cilët kanë impakt në ofrimin e një shërbimi të tillë. Këto komponentë janë planifikimi me eficiencë i shërbimit sa i takon mbështetjes në kuadrin rregullator të duhur dhe analizave e planifikimit financiar sipas mundësive, si dhe rezultatet e zbatimit të kontratës në funksion të përmbushjes me rigorozitet të detyrimeve dhe procesit të mbikëqyrjes.

Sa i takon drejtimit të parë, një proces planifikimi i mirë menduar duhet të mbështetet në ligje, rregullore e standarde e metodologji të hartuara e miratuara për fushat përkatëse. Për këtë rast, rezulton se Bashkia Vlorë nuk ka hartuar rregulloren për shërbimin e pastrimit publik dhe as metodat dhe teknologjitë e përcaktuara për largimin e mbetjeve. Po kështu, BV nuk ka hartuar as rregulloret higjeno-sanitare dhe ekologjike, planet vendore për menaxhimin e integruar të mbetjeve, tregues të performancës së shërbimit dhe indikatorë për matjen e cilësisë së shërbimit, objektiva specifike për shërbimin e pastrimit, apo standarde të tjera të kësaj fushe. Duke mos pasur objektiva të tjera zhvillimore dhe as plane veprimi konkrete me përjashtim të ofrimit të shërbimit standard të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve dhe larjes së rrugëve, BV nuk do ketë mundësinë për përmirësimin e situatës problematike me shërbimin e pastrimit.

Neglizhenca në hartimin e këtyre dokumenteve orientuese përbën edhe një mungesë transparence mbi kuadrin rregullator ku BV mbështet planifikimin e një shërbimi kaq të rëndësishëm dhe as synimet e saj në përmirësimin e situatës në të ardhmen. Lidhur me planifikimin financiar, BV

nuk ka asnjë metodologji apo mënyrë përlllogaritje të tarifës së pastrimit, apo elementët që janë marrë parasysh gjatë përlllogaritjes. Po kështu për asnjë vit tarifa për “pastrim, ndriçim, gjelbërim” nuk mbulon as kontratën e pastrimit brenda qytetit dhe jo më të tre zërat që përfshihen në këtë tarifë, madje tejkalimi është në vlera të konsiderueshme mesatarisht në vlerën e 145% të vlerës së tarifës. Ky fakt vlen po njësoj edhe në rast se tarifa do të mbledhet 100%. Nga shqyrtimi i buxhetit të bashkisë për të tre vitet objekt auditimi rezulton se vetëm për pastrimin brenda qytetit do përdoret rreth $\frac{3}{4}$ e totalit të tarifave vendore, ndërkohë për zërat e mbetur vetëm $\frac{1}{4}$. Edhe krahasuar me të ardhurat totale të Bashkisë, përsëri shpenzimet vetëm për pastrimin brenda qytetit zënë mesatarisht 10% të të gjithë të ardhurave të Bashkisë, duke pasur parasysh këtu gamën shumë të gjerë të shërbimeve apo shpenzimeve të tjera që mbulojnë Bashkitë. Në mënyrë të përmbledhur, për sa më lart vihet re se shpenzimet vetëm për pastrimin brenda qytetit janë jashtë mundësive dhe burimeve financiare të Bashkisë. Po kështu, referuar të dhënave në programin e auditimit të performancës me temë “Menaxhimi i mbetjeve plastike” realizuar në 6 mujin e parë të vitit 2020, rezulton se ndër 3 Bashkitë e marra në vlerësim (Tirana, Vlora dhe Elbasani), Bashkia Vlorë ka vlerën më të lartë të shpenzimeve për pastrimin e qytetit në krahasim me buxhetin në dispozicion.

Lidhur me përlllogaritjen e kostove të shërbimit, Bashkia Vlorë ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të kontratës bazuar në metodologji të caktuara për parashikimin, analizimin dhe përlllogaritjen e kostos, megjithatë rezulton se BV nuk e mbështet përlllogaritjen e kostove të shërbimit në metodologji apo praktika të mira për këtë qëllim. Për përcaktimin e kostove të shërbimit, grupi i auditimit i është referuar përlllogaritjes së fondit limit për këtë shërbim. Pavarësisht se në hyrje të këtij dokumenti përcaktohet se përlllogaritja e fondit të nevojshëm do të bazohet në trendet e rritjes demografike të popullsisë së qytetit, shtrirjes territoriale, krijimin e lagjeve të reja, ndërgjegjësimin e ulët të banorëve në hedhjen e mbeturinave, si dhe niveli i ulët i vjeljes së tarifës së pastrimit, në asnjë rast gjatë përlllogaritjeve nuk u evidentuan këto elementë. Për më tepër, u konstatua se përlllogaritja e fondit limit bazohej në eksperiencën 15 vjeçare për këtë shërbim, për të cilën operatori fitues ka qenë vazhdimisht i njëjti, duke mos marrë parasysh një studim tregu, me tregues të krahasueshëm, të saktë dhe që përshtaten me periudhën dhe karakteristikat në ndryshim të shërbimit të cilat u përmendën më lart. Në përlllogaritjen e këtij fondi janë përfshirë vetëm shpenzime operative si paga dhe kontribute të punonjësve të pastrimit, dezinfektant, vegla pune, ujë, pjesë këmbimi automjetesh dhe kontenierësh, karburant, goma dhe vajra për automjetet, rroba pune, antidote, shpenzime materiale (karro, lopata, fshesa), veshmbathje, etj.

Po kështu, u konstatua se për automjetet është parashikuar zëvendësimi rregullisht çdo vit i gomave dhe nuk janë përmendur normat e konsumit për secilin lloj automjeti. Kosto për këtë shërbim është konsideruar vlera e shpenzimeve për të gjithë elementët e sipër cituar e përkthyer në kosto/kontenier, ndërkohë që për shkak të mungesës së peshores, Bashkia Vlorë nuk ka asnjë informacion mbi sasinë e mbetjeve që prodhon në një ditë, element i cili është thelbësor dhe më kryesori në përlllogaritjen e kostove për këtë qëllim. Planifikimi për shërbimin e ngarkimit dhe largimit të mbetjeve bëhet prej vitesh për një sasi fikse prej 140 ton mbetje/ditë, si në sezonin e mbi populluar të verës, ashtu dhe gjatë sezonit të zbrazët të dimrit. Duke mos pasur të dhëna mbi sasinë ditore të mbetjeve të gjeneruara, është e pamundur të kryhet një përlllogaritje e drejtë dhe reale mbi nevojën për numër kontenierësh dhe më tej për nxjerrjen e kostove/kontenierë.

Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se BV nuk kryen një planifikim financiar eficient të bazuar në të dhëna të sakta dhe koherente mbi elementët që duhet të mbahen parasysh gjatë një planifikimi të tillë. Konkretisht, BV nuk ka marrë në vlerësim gjatë këtij planifikimi as shtimin e numrit të popullsisë dhe bizneseve të reja, as krijimin e lagjeve të reja dhe as nivelin e vjeljes së tarifave, elementë të cilët kanë shumë impakt në këtë lloj shërbimi, por është përqendruar vetëm në shpenzimet operative për këtë shërbim. Së fundmi, pavarësisht shpenzimit të shifrave të konsiderueshme për mundësitë financiare të BV, kjo e fundit paraqet mangësi të konsiderueshme në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe aplikimin e masave apo veprimeve të nevojshme për këtë qëllim.

Sa i takon drejtimit të dytë që lidhet me përmbushjen me rigorozitet të detyrimeve të kontratës dhe procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të saj rezultoi se:

Bashkia Vlorë ka caktuar një punonjëse në rolin e mbikëqyrëses së zbatimit të kontratës (në vijim mbikëqyrësi), e cila është në varësi të Drejtorisë së Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve. Ky person i vetëm ka për detyrë të kontrollojë dhe konfirmojë çdo ditë realizimin e shërbimit të pastrimit për një volum prej 140 ton mbetje në të gjitha pikat e grumbullimit dhe verifikimin e fshirjes së një sipërfaqe prej 810.000 m² rrugësh, dhe larjen dhe lagjen e një sipërfaqe prej 350.000 m² rrugësh.

Nga intervistimi me mbikëqyrësin e kontratës rezultoi se procesi i mbikëqyrjes realizohej në mëngjes herët rreth orës 06:00-10:00 dhe jo në kohë reale gjatë kryerjes së shërbimit. Vetë grupi i auditimit, doli në terren në ditë të ndryshme për të kryer itinerarin e procesit të mbikëqyrjes për zërat e kontratës, nga ku rezultoi se intervali prej 4 orësh ishte i pamjaftueshëm për mbulimin total të të gjitha zonave qytetit. Puna e mbikëqyrësit të kontratës është e dokumentuar vetëm nëpërmjet disa atkntrolleve të thjeshta ditore ku konfirmohet realizimi i punëve të parashikuara sipas volumeve.

Po kështu, lidhur me detyrimet e tjera të mbikëqyrësit konstatohet se nuk përmbushet detyrimi për kontrollin e mjeteve dhe fuqisë punëtore të angazhuar nëpërmjet kësaj kontrate. Mbikëqyrësi nuk kryen një proces rigoroz verifikimi të gjendjes teknike apo dokumentacionit që verifikon këtë aspekt të mjeteve, si dhe nuk administron në dosjen e tij dokumentacionin e duhur për çdo shërbim apo mirëmbajtje që i bëhet mjeteve. Mungesa e transparencës së këtij procesi mund të shoqërohet me kosto financiare, pasi referuar llogaritjes së fondit limit për këtë shërbim, Bashkia Vlorë paguan për çdo element të mirëmbajtjes së këtyre mjeteve si, vajra, pjesë këmbimi, goma, karburant etj. dhe për këtë arsye ka të drejtë të jetë e informuar mbi kostot dhe gjendjen e mjeteve ku po shpenzon. Kjo metodologji verifikimi do të shërbente edhe në përlllogaritjet e ardhshme të fondit limit për kontrata të ngjashme, duke sjellë një përlllogaritje më eficiente. Së fundmi, rezultoi se një pjesë e madhe e punës është e pa dokumentuar, duke rezultuar në mungesë transparence në vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve.

Së fundmi, sa i takon zbatimit të kontratës u konstatua se shërbimi i pastrimit të qytetit nuk ka rezultuar efektiv në çdo element të tij. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve kryhet me korrektësi, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për procesin e dezinfektimit të zonës përreth apo larjes dhe dezinfektimit të kontenierëve dhe mjeteve teknologjike. Grupi i punës për hartimin e grafikëve dhe përcaktimin e pikave të vendosjes së kontenierëve nuk ka kryer një planifikim të saktë për shpërndarjen e tyre, duke qenë se në shumë raste kontenierët ishin të tej mbushur që në orët e para të paradites. Si pasojë e mungesës së peshores, dokumentacioni i mbajtur për zbatimin e kontratës plotësohet formalisht dhe nuk pasqyrohen saktë në këto dokumente volumet reale të mbetjeve të mbledhura çdo ditë.

Përcaktimet e kontratës lidhur me riparimin apo mirëmbajtjen e kontenierëve nuk janë përmbushur dhe po kështu nuk është përmbushur as detyrimi i mbajtjes së vlerave të riparimeve nga situacionet pasardhëse. Procesin e larjes dhe fshirjes nuk është i mirë planifikuar sa i takon orareve të operimit për secilin shërbim, apo alternimit të ditëve dhe këtyre orareve sipas nevojës, lidhur me rastet e motit me shi apo radhën e kryerjes së proceseve.

Gjatë planifikimit të shërbimit, bashkia Vlorë nuk ka marrë në shqyrtim zgjidhje e problemit të pranishëm të mjeteve të parkuara gjatë procesit të larjes dhe fshirjes së rrugëve, duke i lënë kunetat dhe pjesët anësore të rrugëve me pluhur dhe baltë. Gjithashtu, lidhur me detyrimin për edukimin publik dhe ambiental, rezultoi se modelet e fletë/palosjes/broshurave të shpërndara nuk përmbajnë informacion apo elementë ndërgjegjësues sa i takon edukimit publik. Si pasojë e konstatimit të vazhdueshëm të hedhjes së mbetjeve të pa përshtatshme jashtë kontenierëve, operatori ekonomik ka dështuar në përmbushjen e detyrimit për edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve. Në këtë kontekst edhe Bashkia Vlorë ka qenë neglizhente në penalizimin e shkelësve të këtyre rregullave, si dhe të mbledhësve të pa autorizuar të plastikës.

6. Aneksë

Në këtë kapitull, pasqyrohen nëpërmjet fotove, rezultatet e vizitave të grupit të auditimit në terren. Vizitat në terren janë realizuar në datat 14-15/10; 22/10; 29-30/10 dhe 6/11. Fotot dhe konstatimet gjatë vizitave po i grupojmë sipas zërave të kontratës.

1. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve nga pikat e depozitimit, si dhe procesi i dezinfektimit dhe gjendja e kontenierëve



Rruga Hajredin Haxhiraj – Kontenierë të tejmbushur



Rruga Niko Hoxha – mbetje të pa pranueshme



Rruga Francesco Krispi - mbetje të pa pranueshme jashtë kontenierëve. Zona përreth e pa dezinfektuar



Rruga Dalan Dadani – mbetje të pa pranueshme jashtë kontenierëve

Rruga Zenel Murra - kontenierë të dëmtuar e deformuar; zona e pa dezinfektuar





Shtëpia Muze Eqerem Bej Vlora – kontenierë të tej mbushur që në orët e para të mëngjesit



Blok banimi mes rrugës Aristill Kokoshi dhe Naim Frashëri – kontenierë të dëmtuar; mbetje të pa pranueshme jashtë tyre; dezinfektimi i hershëm



Rruga Shyqyri Ali Merko – mbetjet në kontenierë të hequr, por jo ato jashtë tyre; zona e pa dezinfektuar



Rruga Dhimitër Konomi – kontenierë të dëmtuar; zona me dezinfektim të hershëm



Rruga Aristill Kokoshi – kontenierë të dëmtuar; zona e pa dezinfektuar



Rruga Nexhat Haku – kontenier i dëmtuar; zona perreth e pa pastruar dhe pa dezinfektuar



Rruga Çajupi – zona përreth e pa pastruar dhe shumë pak e dezinfektuar



Rruga Gjergj Arianiti – kontenierë të dëmtuar; zona përreth e pa pastruar dhe pa dezinfektuar



Rruga Çajupi – mbetje të pa pranueshme; zona përreth e pa dezinfektuar



E njëjta pikë depozitimi si më lart, në ditë të ndryshme



Zonë banimi në rrugën Gjergj Arianiti – mbetje inerte në rrugë



Rruga David Selanicas – zona përreth e pa pastruar dhe pa dezinfektuar



Rruga Fiqiri Muka – kontenierë të tejmbushur; zonë shumë e ngushtë dezinfektimi



Rruga Andrea Varfi – kontenierë të dëmtuar; zona përreth e pa pastruar dhe pa dezinfektuar



Rruga Ali Demi – mbetje të pa pranueshme përgjatë rrugës



Rruga Andrea Varfi – zona përreth e pa pastruar dhe jo plotësisht e pa dezinfektuar



Rruga Ali Demi – mbetje të pa pranueshme jashtë kontenierëve; dezinfektimi vetëm nga një krah i tyre



Zonë e banuar kufizuar nga rrugët Sali Bedini dhe Miss Durham (rrugë e pa identifikuar) – kontenierë të dëmtuar; zona përreth e pa pastruar dhe dezinfektuar

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" nr. 1;

Tiranë: Tel: 00355 4 2247 294; web: www.klsh.org.al



Lagjia 24 maji, 2.6 km nga qendra e qytetit



Rruga Sotir Leka – Kontenier i dëmtuar, zona e pa pastruar dhe dezinfektuar



Rruga Sazani – kontenierë të pa dezinfektuar



Rruga Sotir Leka – Kontenier i dëmtuar, zona e pa pastruar dhe dezinfektuar



Rruga Sazani – kontenierë të pa dezinfektuar



Rruga Sotir Leka – mbetje kudo përgjatë rrugës



Rruga Sotir Leka – grumbuj mbetjesh të pa pranueshme



Rruga Zaho Koka – kontenierë të tej mbushur; zona e pa dezinfektuar



Rruga Sotir Leka – Kontenier të dëmtuar, zona e pa pastruar dhe dezinfektuar



Rruga Zaho Koka – kontenierë të dëmtuar; zona e pa dezinfektuar



Rruga Miss Durhan – kontenier i deformuar; zona e pa dezinfektuar



Rruga Mahmude Lagji – mbetje inerte jashtë kontenierëve; zona përreth e pa pastruar dhe pa dezinfektuar



Rruga Miss Durham – zona e pa dezinfektuar



Rruga Dhimitër Konomi – kontenierë të dëmtuar; zona e pa dezinfektuar



Rruga Dëshmorët – kontenierë të tejmbushur; zona jo plotësisht e dezinfektuar



Rruga Reshat Osmani - kontenierë të tejmbushur; zona jo plotësisht e dezinfektuar

2. Fshirja dhe larja e rrugëve




Rruga Gjergj Kastrioti - -- krahu i parkimit të makinave e pa gërryer dhe me prani të konsiderueshme pluhuri



Vijim i rrugës Miss Durhan



Rruga Anita Bitri – e pa fshirë dhe e pa larë, prani e konsiderueshme pluhuri



Rruga Tasin Jonuzi – prani parkimesh, e pa gërryer dhe fshirë



Rruga Demokracia – trotuari i pa fshirë



Rruga Fejzo Mema – prani mbetjesh



Rruga Sazani – e pa fshirë